



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

VLERËSIMI I JASHTËM DHE I BRENDSHËM I SHKOLLËS

Maj, 2020



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 1368/2 Prot.

Tiranë, më 28.8. 2020

URDHËR

Nr. 268, datë 28.8. 2020

PËR

MIRATIMIN E PAKETËS SË VLERËSIMIT TË CILËSISË SË SHKOLLËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të shkronjës c, pika 2, neni 26, i ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të shkronjës d, pika 5, kreu III, i Vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP)”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e produkteve të “Paketës së vlerësimit të cilësisë së shkollës”, bashkëlidhur këtij urdhri e cila përmban:
 - a. Kornizën e vlerësimit të cilësisë së shkollës.
 - b. Vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës.
 - c. Metodologjinë e vlerësimit të brendshëm të shkollës.
 - ç. Metodologjinë e vlerësimit të jashtëm të shkollës.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
BESA SHAHINI



Këshilli redaktues:

Dr. Gerti Janaqi

Dr. Teuta Çobaj

Eniana Veli

Majlinda Ucaj

Shemsi Muça

Irida Sina

Në hartimin e udhëzuesit “Vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm i shkollës” kontribuan grupet e punës sipas fushave, si më poshtë:

Drejtimi dhe menaxhimi: Teuta Çobaj, Majlinda Ucaj, Koço Josifi, Zija Kurti, Albana Markja

Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënësve: Eniana Veli, Shemsi Muça, Mimoza Matraxhiu, Uzri Alku, Erida Koleci, Majlinda Hala

Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve: Antoneta Ramaj, Rudina Spahiu, Arjan Farka, Evis Mastori, Ines Todhe

Mirëqenia dhe sjellja e nxënësve: Irida Sina, Mirela Kondili, Majlinda Lika, Anastas Kacori, Anisa Ahmati, Astrit Dauti, Esion Zgjana.

Falënderojmë për idetë dhe sugjerimet e vlefshme, që kanë dhënë në takimet e posaçme të punës për këtë udhëzues, specialistë të DPAP-së, DRAP-ve, ZVAP-ve, si dhe drejtues e mësues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në qytete të ndryshme të vendit.

Redaktor gjuhësor: Zija Kurti

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	5
VLERËSIMI I JASHTËM DHE I BRENDSHËM I SHKOLLËS.....	6
FUSHA I. DREJTIMI DHE MENAXHIMI	9
FUSHA II. CILËSIA E MËSIMDHËNIES DHE E TË NXËNIT.....	15
FUSHA III. VLERËSIMI DHE ARRITJET E NXËNËSVE	20
FUSHA IV. MIRËQENIA DHE SJELLJA E NXËNËSVE.....	25
BAZA LIGJORE	30
PËRKUFIZIME	34
BIBLIOGRAFIA	39

HYRJE

Përmirësimi i cilësisë dhe i efektivitetit të arsimit parauniversitar është në qendër të vëmendjes së politikave të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Vlerësimi i cilësisë së shkollës, në nivel global, konsiderohet si garanti i kërkesave të shoqërisë për një shkollë të mirë. Sistemi i vlerësimit bëhet në këtë mënyrë, një komponent kyç në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe edukimit të nxënësve. Vlerësimi sistematik identifikon se çfarë është arritur dhe çfarë duhet të përmirësohet në shkollë.

Termi “përmirësim”, në këtë kontekst, përshkruan proceset që shkolla ndërmerr në një këndvështrim bashkëpunues me të gjithë aktorët, për të plotësuar interesat dhe nevojat e të gjithë nxënësve, për të arritur rezultatet e pritshme të të nxënësve, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit arsimor.

Cilësia e shkollës përfaqëson një koncept kompleks, ndaj për ta vlerësuar atë, duhet të vlerësojmë jo vetëm arritjet akademike të nxënësve, por edhe çështje, të tilla si: cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënësve, drejtimi dhe menaxhimi i shkollës, mirëqenia dhe sjellja e nxënësve etj.

Nisur nga kurrikula me bazë kompetencash dhe reformat e ndërmarra në arsimin parauniversitar, lindi e nevojshme hartimi i Kornizës së Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës, nga e cila buron edhe udhëzuesi “Vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm i shkollës”.

Udhëzuesi “Vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm i shkollës” mundëson realizimin e vlerësimit të jashtëm, të vlerësimit të brendshëm, ndërlidhjen midis tyre, si dhe përmirësimin e organizimit dhe funksionimit të shkollës. Përvojat e deritanishme dëshmojnë efektivitetin e lidhjes mes dy vlerësimeve, në kuptimin e përdorimit të së njëjtës gjuhë standarde vlerësimi. Aktorët vlerësues, jashtë dhe brenda shkollës, përcaktojnë vlerat për informacionin e grumbulluar nga procesi i matjeve, me element kryesor gjykimin.

Ky udhëzues u shërben vlerësuesve/inspektorëve, drejtuesve, mësuesve dhe aktorëve të tjerë për të vlerësuar cilësinë e shkollës, me qëllim sigurimin e llogaridhënies dhe transparencës për veprimtarinë mësimore-edukative të saj.

Shkollat e sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri, në aspektin vertikal të llogaridhënies, raportojnë në nivelin lokal në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) dhe Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) përkatëse. ZVAP-të dhe DRAP-et raportojnë në nivel kombëtar te Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP). Nga ky këndvështrim, vlerësimi i jashtëm, vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi krahasues (Karta e Performancës) janë mënyrat kryesore, se si realizohet raportimi dhe mundësohet llogaridhënia. Gjithashtu, në aspektin horizontal të llogaridhënies, sistemi i vlerësimit, përmes raportimeve, informon prindërit, nxënësit dhe palët e interesuara për cilësinë e shërbimit të ofruar nga shkolla.

VLERËSIMI I JASHTËM DHE I BRENDSHËM I SHKOLLËS

Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës standardizon sistemin e vlerësimit, nëpërmjet përcaktimit të koncepteve themelore, si: fushat e cilësisë, kriteret e cilësisë, treguesit e cilësisë, përshkruesit praktikë, shkallët e vlerësimit dhe trendi i rivlerësimit.

Fushat e cilësisë janë shtyllat kryesore që lidhen drejtpërdrejt me gjithë veprimtarinë e shkollës. Përcaktimi i fushave të cilësisë është bazuar në aktet ligjore, qëllimet e arsimit parauniversitar, dokumentet kurrikulare, përvojat kombëtare dhe qasjet ndërkombëtare. Fushat e cilësisë janë:

- Drejtimi dhe menaxhimi;
- Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënësve;
- Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve;
- Mirëqenia dhe sjellja e nxënësve.

Kriteret e cilësisë janë përcaktuar, bazuar në ndërveprimin mes fushave të cilësisë dhe parimeve të Kornizës së Kurrikulës të Arsimit Parauniversitar. Kriteret e cilësisë përshkruajnë pritshmëritë themelore që duhet të përmbushen nga çdo shkollë, që funksionon në Republikën e Shqipërisë, dhe i orientojnë ato për përmirësimin e tyre të vazhdueshëm. Secila fushë ka 6 kriteret e vlerësimit, të cilat burojnë nga gjashtë parimet e kurrikulës, duke vënë në dukje ndikimin e secilit parim në secilën fushë të veprimtarisë së shkollës. Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës ka gjithsej 24 kriteret e cilësisë.

Treguesit e cilësisë janë fjali pohuese të pritshmërisë së performancës së shkollës, në kuadër të kriterëve të cilësisë të fushës përkatëse. Treguesit na ndihmojnë për të konstatuar nivelin e cilësisë së shkollës në raport me pritshmëritë. Treguesit e cilësisë janë një sistem i treguesve *sasiorë* dhe *cilësorë*, që përdoren për të monitoruar dhe vlerësuar cilësinë e arsimit në nivele të ndryshme. Qëllimi i këtyre treguesve është të karakterizojnë natyrën e sistemit, nëpërmjet komponentëve të tij, si janë të lidhur me njëri-tjetrin dhe si ndryshojnë në kohë. Pra, i gjithë informacioni i siguruar nga sistemi i treguesve është më i madh, sesa shuma e pjesëve të tij. Një gjykim i saktë dhe i drejtë sigurohet vetëm, duke përdorur sistemin e treguesve (sasiorë dhe cilësorë) dhe jo tregues të veçuar për vlerësimin e performancës së shkollës.

Përshkruesit praktikë (treguesit specifikë) janë fjali përshkruese për vëzhgimin në praktikë të procesit të vlerësimit. Ata përcaktojnë se si është hartuar, zbatuar dhe si është zhvilluar treguesi i cilësisë. Nëpërmjet përshkruesve praktikë mblidhen informacione dhe të dhëna në shkollë për të vlerësuar treguesit.

Shkalla e vlerësimit është një metodë e përdorur për të vlerësuar gjykimin *me shprehje* ose *me numra*, në lidhje me një aspekt, objekt, karakter ose një atribut të veprimtarisë së shkollës. Shkalla e vlerësimit dhe normat përkatëse të vlerësimit përbëjnë sistemin që

përdoret nga vlerësuesi gjatë vlerësimit të cilësisë, në kushtet reale të shkollës. Nivelet e vlerësimit, sipas shkallës numerike, janë 4, përkatësisht: 1, 2, 3, 4, ku niveli 1 i përket shkallës më të ulët dhe niveli 4 shkallës më të lartë.

Vlerësimi sipas shkallës së cilësisë, kryhet referuar shprehjeve: shumë mirë, mirë, mjaftueshëm dhe dobët.

Norma e vlerësimit është model standard, që përcakton shkallën e cilësisë sipas nivelit të vlerësimit.

NIVELET E VLERËSIMIT	NORMA E VLERËSIMIT	SHKALLËT E CILËSISË
4	Ka realizuar nga 90% - 100% të përshkruesve praktikë	Shumë mirë
3	Ka realizuar 75% - 89% të përshkruesve praktikë	Mirë
2	Ka realizuar 51% - 74% të përshkruesve praktikë	Mjaftueshëm
1	Ka realizuar nën 50% të përshkruesve praktikë	Dobët

Më poshtë janë paraqitur përshkrime të përgjithshme të vlerësimeve, të cilat përdoren gjatë procesit të vlerësimit në shkollë.

Përshkruesit praktikë vlerësohen sipas niveleve të vlerësimit: 1, 2, 3, 4.

Treguesit e cilësisë vlerësohen sipas shkallës së cilësisë, në përputhje me normën e vlerësimit të përshkruesve praktikë, përkatësisht:

- *Shumë mirë*: kur shkolla ka realizuar 90% - 100% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues;
- *Mirë*: kur shkolla ka realizuar 75% - 89% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues;
- *Mjaftueshëm*: kur shkolla ka realizuar 51% - 74% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues;
- *Dobët*: kur shkolla ka realizuar nën 50% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues.

Fushat e cilësisë vlerësohen duke llogaritur mesataren aritmetike të vlerësimit të treguesve të cilësisë të asaj fushe.

Vlerësimi i shkollës kryhet duke llogaritur mesataren aritmetike të vlerësimit të fushave të cilësisë.

Trendi është shkalla e cila përcakton cilësinë e shkollës, që realizohet në rivlerësim apo në vlerësimin periodik të shkollës, duke u mbështetur në krahasimin e vlerësimeve të tjera të kryera në shkollë.

TRENDI		PËRSHKRIMI
Niveli	Shkalla	
5	Shkëlqyeshëm	Performanca e shkollës i ka tejkaluar pritshmëritë, duke arritur një cilësi jashtëzakonisht të lartë të punës së kryer në të gjitha fushat. Shkolla ka qëllime/synime të larta për performancën e saj. Ky vlerësim është i arritshëm nga çdo punonjës, megjithëse i dhënë rrallë.
4	Tejkalon pritshmëritë	Performanca shpesh tejkalon pritshmëritë në të gjitha fushat e përgjegjësisë dhe cilësia e punës në përgjithësi, është shumë e mirë. Prioritetet/objektivat vjetorë janë përmbushur.
3	Përmbush pritshmëritë	Performanca është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha fushat e përgjegjësisë, brenda afateve të përcaktuara, ndoshta duke tejkaluar pritshmëritë, dhe cilësia e punës në përgjithësi, është shumë e mirë. Prioritetet/objektivat vjetorë më të rëndësishëm janë përmbushur.
2	Përmirësim i nevojshëm	Performanca e shkollës nuk përputhet në mënyrë të vazhdueshme me pritshmëritë. Performanca nuk ka arritur të përmbushë një ose më shumë nga prioritetet/objektivat e shkollës. Është e nevojshme të hartohet një plan zhvillimi profesional për të përmirësuar performancën, duke përcaktuar afatet kohore dhe duke monitoruar në vijimësi matjen e progresit.
1	I pakënaqshëm	Performanca vazhdon të jetë nën pritshmëritë, në fushat më të rëndësishme të përgjegjësisë, dhe nuk vihet re asnjë progres drejt prioriteve. Është i domosdoshëm përmirësimi i menjëhershëm në një ose më shumë fusha të rëndësishme. Nevojitet një plan urgjent për të rritur performancën, duke përfshirë afatet kohore, si dhe duhet të monitorohet në vijimësi matja e progresit.

FUSHA 1. DREJTIMI DHE MENAXHIMI

Shkolla është vendi ku bashkohen dhe integrohen të gjitha investimet për të përmirësuar cilësinë e rezultateve të nxënësve. Kjo është arsyeja pse shumë vende të botës po përqendrohen në organizimin dhe funksionimin e shkollës, ku roli i drejtorit ka dalë, si asnjëherë tjetër, në plan të parë. Ndryshimet e shumta që kanë ndodhur në sistemin arsimor parauniversitar, si rezultat i reformave të ndërmarra, kërkojnë edhe ndryshimin e funksioneve të drejtorit të shkollës, në drejtues dhe menaxher të saj.

Drejtimi dhe menaxhimi i shkollës janë një binom thelbësor për të planifikuar, koordinuar dhe kontrolluar realizimin e vizionit të shkollës. Drejtimi dhe menaxhimi plotësojnë njëri-tjetrin, duke kombinuar liderin e organizatës shkollore dhe atë të menaxherit të burimeve dhe veprimtarive mësimore-edukative, të cilat së bashku sigurojnë sukses në zhvillimin e qëndrueshëm të shkollës.

“*Drejtim*” do të thotë të kesh një vizion të qartë mbi cilësinë e shërbimit që institucioni duhet të ofrojë dhe të jesh i aftë të motivosh e frymëzosh punonjësit mësimorë të institucionit për të përmbushur vizionin, kurse “*Menaxhim*” është organizimi i personelit të institucionit për të hartuar dhe realizuar synime dhe objektiva që mundësojnë përmbushjen e këtij vizioni. Sot, më shumë se kurrë, drejtuesi i shkollës është forca lëvizëse, nxitëse dhe garantuese e realizimit të vizionit të shkollës, ku ai është përgjegjës për ofrimin e një shërbimi cilësor edukimi e arsimimi, transparent dhe llogaridhënës ndaj përfituesve të tij.

Në këtë perspektivë, drejtuesi i shkollës duhet të ketë një vizion të qartë të orientimit strategjik për vetorganizimin, gatishmërinë për punën në grup, një sistem të përgjegjshëm dhe llogaridhënës, të ndërtuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, të njohur dhe të pranuar nga i gjithë komuniteti i shkollës, i cili reflekton nevojat specifike të nxënësve dhe interesat e tyre.

Procesi i vlerësimit të cilësisë së shkollës në fushën “Drejtimi dhe menaxhimi”, bazohet në standardet profesionale për formimin e drejtuesve të institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar dhe mat, gjykon e vlerëson, se sa drejtori i shkollës ka:

- drejtuar planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e vizionit dhe prioriteteve të shkollës;
- krijuar një proces mësimor të rregullt, të sigurt dhe të qëndrueshëm, për të siguruar një mësimdhënie efektive nëpërmjet zbatimit cilësor të kurrikulës;
- menaxhuar burimet njerëzore në mënyrë të barabartë, të drejtë dhe të paanshme;
- menaxhuar burimet financiare për të plotësuar nevojat dhe interesat e nxënësve;
- krijuar një kulturë të bashkëpunimit profesional, si lider pedagogjik, duke zhvilluar një sistem për të promovuar përgjegjësinë profesionale, llogaridhënien dhe transparencën;
- vlerësuar mësuesit dhe menaxhuar vetëvlerësimin e tyre mbi bazën e standardeve të mësuesit dhe arritjeve të nxënësve;
- ndërtuar partneritetin me prindërit dhe komunitetin, për të siguruar një shërbim cilësor për të gjithë nxënësit.

Kriteret dhe treguesit e cilësisë së fushës: Drejtimi dhe menaxhimi

FUSHA 1: DREJTIMI DHE MENAXHIMI		
PARIMET E KURRIKULËS	KRITERET E CILËSISË	TREGUESIT E CILËSISË
Konceptim i gjerë dhe me bazë kompetencash	Drejtori udhëheq planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e prioriteteve të shkollës, në funksion të zhvillimit të kompetencave themelore, që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit.	1. Drejtori, në bashkëpunim me grupet e interesit, ka siguruar një vizion për shkollën në përputhje me politikat arsimore. 2. Drejtori ka shndërruar në një kulturë të vijueshme procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës me të gjithë aktorët e shkollës, për përmirësimin e vazhdueshëm të saj. 3. Drejtori ka drejtuar hartimin e rregullores së brendshme, për funksionimin e shkollës në përputhje me aktet ligjore e nënligjore. 4. Drejtori menaxhon në mënyrë efektive burimet njerëzore, për të ofruar një shërbim profesional në përmbushje të qëllimeve të shkollës. 5. Drejtori menaxhon burimet financiare në mënyrë efektive dhe transparente për të mbështetur prioritetet kyçe. 6. Drejtori siguron zhvillimin e kurrikulës së zbatuar në shkollë, mbështetur në kompetencat e të nxënësve gjatë gjithë jetës, për të përmbushur aspiratat e nxënësve, të mësuesve, të prindërve dhe të komunitetit. 7. Drejtuesit e shkollës vlerësojnë arritjet e nxënësve, të stafit dhe të ekipeve të ndryshme, duke promovuar në mënyrë të vazhdueshme standarde të larta. 8. Drejtori siguron transparencën e arritjeve të shkollës për prindërit e komunitetin, nëpërmjet plotësimit të saktë të Kartës së Performancës. 9. Drejtori mundëson zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit pedagogjik, në funksion të përmirësimit të zbatimit të kurrikulës, të mësimdhënies dhe të të nxënësve. 10. Drejtori ndërton marrëdhënie të ndërsjella partneriteti mes shkollës dhe komunitetit, për edukimin cilësor të të gjithë nxënësve. 11. Drejtori ka ngritur organizmat e shkollës, për ndërtimin e një mjedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm. 12. Drejtori administron dokumentacionin shkollor në ruajtje të përhershme/të përkohshme dhe bazën materiale, në përputhje me aktet/rregulloret përkatëse.
Gjithëpërfshirja	Drejtori siguron përfshirjen e gjithë aktorëve të interesuar në jetën e shkollës, për të garantuar përmirësimin e vazhdueshëm të shkollës.	
Baraspesha dhe integritet	Drejtori menaxhon situatat komplekse në mënyrë të barabartë, të drejtë e të paanshme, si dhe zhvillon e zbaton një sistem për të promovuar përgjegjësinë profesionale dhe llogaridhënien.	
Vijimësia	Drejtori siguron kushte për një proces mësimor të rregullt, të sigurt dhe të qëndrueshëm, si dhe krijon një kulturë të vazhdueshme të zhvillimit profesional.	
Bashkëpunimi dhe partneriteti	Drejtori ndërton partneritetin shkollë-familje-komunitet, si një mekanizëm i rëndësishëm në planifikimet dhe vendimmarrjet e shkollës.	
Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle, përgjegjshmëria	Drejtori siguron autonominë, fleksibilitetin dhe ndan përgjegjësitë në realizimin e prioriteteve, synimeve dhe objektivave, bazuar në nevojat e interesat e të gjithë nxënësve.	

Treguesit e cilësisë dhe përshkruesit praktikë të fushës: Drejtimi dhe menaxhimi

FUSHA 1: DREJTIMI DHE MENAXHIMI								
TREGUESIT E CILËSISË	PËRSHKRUESIT PRAKTIKË	NIVELET E VLERËSIMIT						
		1	2	3	4			
1.1. Drejtori, në bashkëpunim me grupet e interesit, ka siguruar një vizion për shkollën në përputhje me politikat arsimore.	1.1.1. Drejtori ka ngritur grupet e punës për hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm dhe planit vjetor, me përfshirjen e të gjithë aktorëve të shkollës.							
	1.1.2. Plani afatmesëm është hartuar në përputhje me formatin zyrtar.							
	1.1.3. Misioni përmbledh detyrimin apo përgjegjësitë që ka shkolla gjatë katër viteve shkollore.							
	1.1.4. Vizioni i shkollës, i cili është i formuluar qartë, i njohur dhe i mirëkuptuar nga stafi pedagogjik, përmbledh aspiratën e komunitetit dhe të punonjësve arsimorë për cilësinë e shërbimit arsimor të ofruar.							
	1.1.5. Analiza e gjendjes në planin afatmesëm jep një panoramë të qartë të shkollës, duke specifikuar anët e forta, anët e dobëta, si dhe treguesit specifikë.							
	1.1.6. Grupi i punës ka përcaktuar në planin afatmesëm, përparësitë mbi drejtimet kryesore të përmirësimit të shkollës dhe veprimtaritë për realizimin e tyre.							
	1.1.7. Plani vjetor është mbështetur në planin afatmesëm, planin e përmirësimit ¹ , analizën e gjendjes, si dhe sugjerimet e nxënësve, prindërve, mësuesve dhe grupeve të interesit.							
	1.1.8. Plani vjetor është hartuar në përputhje me formatin zyrtar.							
	1.1.9. Analiza e gjendjes në planin vjetor përmban të gjithë treguesit sipas udhëzimit zyrtar, ku për secilin tregues janë përcaktuar një deri dy anë të forta dhe të dobëta.							
	1.1.10. Synimi i planit vjetor përshkruan një përparësi të shkollës për t’u realizuar gjatë atij viti shkolle.							
	1.1.11. Objektivat e planit vjetor, formuluar sipas kriterëve, janë rrjedhojë logjike e synimit.							
	1.1.12. Grupi i punës ka përcaktuar veprimtaritë për realizimin e secilit objektivi, me afatet kohore dhe personat përgjegjës.							
	1.1.13. Drejtori zbaton procedurat përkatëse për miratimin e planit afatmesëm dhe planit vjetor.							
	1.1.14. Drejtorja e shkollës monitoron veprimtaritë vëzhguese për realizimin e planeve (afatmesëm dhe vjetor).							
	1.1.15. Drejtori raporton te bordi i shkollës mbi ecurinë e arritjes së prioritetëve dhe objektivave.							
	1.1.16. Grupi i punës i kryesuar nga drejtori ka hartuar raportin vjetor sipas udhëzimeve zyrtare.							
1.2. Drejtori ka shndërruar në një kulturë të vijueshme procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës me të gjithë aktorët e shkollës, për përmirësimin e	1.2.1. Shkolla realizon çdo vit vlerësimin e brendshëm, në të cilin përfshin të gjithë punonjësit arsimorë të shkollës, psikologun, punonjësin social, oficerin e sigurisë dhe sekretarin.							
	1.2.2. Shkolla realizon vlerësimin e brendshëm, në nivel individual dhe në nivel organizmesh.							
	1.2.3. Secili drejtues, mësues dhe organizëm ka kryer vetëvlerësimin e tij, duke përdorur metoda dhe instrumente të përzgjedhura nga këshilli i mësuesve.							
	1.2.4. Vlerësimi i brendshëm është realizuar nga një grup qendror, i cili përbëhet nga anëtarët e drejtorisë dhe kryetarët e ekipeve lëndore.							

¹ Plani i përmirësimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës.

vazhdueshëm të saj.	1.2.5. Vlerësimi i brendshëm është realizuar sipas etapave të përcaktuara në udhëzuesin metodologjik për vlerësimin e brendshëm.				
	1.2.6. Raporti i vlerësimit të brendshëm është hartuar sipas formatit standard, ku janë përcaktuar anët e forta, anët që kanë nevojë për përmirësim dhe faktorët që kanë penguar ose favorizuar cilësinë.				
	1.2.7. Plani i përmirësimit ² përshkruan objektivat në lidhje me kriteret e cilësisë.				
	1.2.8. Drejtori monitoron në vijimësi zbatimin e planit të përmirësimit.				
	1.2.9. Drejtori mbështet procesin e vlerësimit të brendshëm, pa ndikuar në rezultat.				
1.3. Drejtori ka drejtuar hartimin e rregullores së brendshme, për funksionimin e shkollës në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.	1.3.1. Drejtori ka ngritur grupin e punës për hartimin e rregullores së brendshme, me nxënës, mësues, prindër dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit.				
	1.3.2. Rregullorja e brendshme përmban të gjitha rubrikat e parashikuara në udhëzimin zyrtar.				
	1.3.3. Drejtori ka miratuar në ZVAP rregullat e disiplinës në shkollë dhe masat për moszbatimin e tyre.				
	1.3.4. Drejtori ka kryer procedurat sipas udhëzimit zyrtar, për miratimin dhe informimin e rregullores së brendshme.				
	1.3.5. Drejtori monitoron në vijimësi, zbatimin e rregullores së brendshme.				
1.4. Drejtori menaxhon në mënyrë efektive burimet njerëzore, për të ofruar një shërbim profesional në përmbushje të qëllimeve të shkollës.	1.4.1. Drejtori në bashkëpunim me ZVAP-në, ka evidentuar nevojat reale për stafin mësuesor e ndihmës.				
	1.4.2. Drejtori ka përcaktuar pritshmëritë për të gjithë stafin e shkollës në lidhje me zhvillimin e gjithë veprimtarisë mësimore- edukative, bazuar në aftësitë dhe specifikimet profesionale të secilit.				
	1.4.3. Drejtori ka ndarë detyrat dhe përgjegjësitë për nëndrejtorin/ët dhe stafin e shkollës.				
	1.4.4. Drejtori ka balancuar ngarkesën mësimore javore të stafit mësuesor, sipas normës zyrtare, me lëndë të profilit të tyre ose të përafërt.				
	1.4.5. Drejtori monitoron hartimin dhe realizimin e planeve të orëve të kujdestarisë nga mësuesit.				
	1.4.6. Drejtori kryen procedurat për regjistrimin/transferimin e nxënësve sipas udhëzimeve zyrtare.				
	1.4.7. Drejtori i shkollës së arsimit bazë, në bashkëpunim me kryeplakun, inspektorin e policisë dhe ZVAP-në, siguron ndjekjen e shkollës nga të gjithë nxënësit e moshës së arsimit të detyruar.				
	1.4.8. Drejtori ka formuar klasat në përputhje me udhëzimin zyrtar.				
1.5. Drejtori menaxhon burimet financiare në mënyrë efektive dhe transparente për të mbështetur prioritetet kyçe.	1.5.1. Shkolla siguron të ardhura nga shërbime për të tretët dhe burime financiare/mbështetje materiale nga dhurues/sponsorizues, për të realizuar prioritetet kyçe, në përputhje me udhëzimet zyrtare.				
	1.5.2. Shkolla përdor të ardhurat e saj në mënyrë efektive, në funksion të arritjeve të nxënësve.				
	1.5.3. Bordi i shkollës siguron kontribute të ligjshme (vendase/të huaja) për mbarëvajtjen e institucionit.				
	1.5.4. Shkolla realizon transparencë për përdorimin e burimeve financiare.				
	1.5.5. Drejtori monitoron në vijimësi përdorimin e të ardhurave.				
1.6. Drejtori siguron zhvillimin e kurrikulës së zbatuar në shkollë, mbështetur në kompetencat e të nxënësve gjatë gjithë jetës, për të	1.5.6. Bordi i shkollës ka informuar grupet e interesit për raportin vjetor.				
	1.6.1. Drejtori siguron për të gjithë nxënësit kurrikulën bërthamë, kurrikulën me zgjedhje dhe shërbimin komunitar (për AML-në), sipas planit mësuesor.				
	1.6.2. Drejtori planifikon kurrikulën me zgjedhje (lëndë të veçanta, module, projekte, veprimtari të ndryshme të kurrikulës bërthamë dhe asaj ndërkurrikulare), në përputhje me nevojat e të gjithë nxënësve, zhvillimet rajonale, si dhe potencialet e mundësitë e shkollës.				
	1.6.3. Drejtori ka nxjerrë vendimin për lëndët/modulet me zgjedhje, pas konsultimit me ekipin kurrikular, qeverinë e				

² Plani i përmirësimit paraqet shkurtimisht veprimet konkrete që lidhen me planet zhvillimore të shkollës.

përmbushur aspiratat e nxënësve, të mësuesve, të prindërve dhe të komunitetit.	nxënësve, këshillin e prindërve dhe bordin e shkollës.				
	1.6.4. Shkolla identifikon potencialin e të gjithë prindërve e partnerëve si ekspertë të veçantë, për të mbështetur zbatimin e kurrikulës.				
	1.6.5. Drejtori dhe mësuesit kujdestarë informojnë nxënësit dhe prindërit për kurrikulën bërthamë, kurrikulën me zgjedhje dhe kurrikulën në bazë shkolle.				
	1.6.6. Shkolla informon nxënësit dhe prindërit për përmbajtjen e programeve lëndore, planeve lëndore, rezultateve të të nxënësve dhe kriterëve të vlerësimit, në fillim të vitit shkollor.				
	1.6.7. Shkolla, në bashkëpunim me prindërit, realizon planin për këshillimin e karrierës së nxënësve, për kalimin e nxënësve nga një nivel shkollor në tjetrin.				
1.7. Drejtuesit e shkollës vlerësojnë arritjet e nxënësve, të stafit dhe të ekipeve të ndryshme, duke promovuar në mënyrë të vazhdueshme standarde të larta.	1.6.8. Shkolla realizon takime me punonjës arsimorë të shkollave të mesme/pedagogë të institucioneve të arsimit të lartë dhe profesionistë në mjedise të mundshme punësimi.				
	1.7.1. Drejtuesit hartojnë planet vjetore/mujore/javore për vlerësimin e procesit mësimor.				
	1.7.2. Drejtuesit realizojnë normën zyrtare për vlerësimin e arritjeve, duke përdorur formate standarde për vlerësimin e procesit të mësimdhënies/nxënies dhe të plotësisë të dokumentacionit shkollor.				
	1.7.3. Drejtuesit hartojnë raporte vlerësimi me rekomandime e sugjerime, për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor.				
	1.7.4. Drejtuesit zhvillojnë teste me short në të gjitha lëndët/fushat, për të evidentuar progresin e nxënësve.				
	1.7.5. Drejtori, në bashkëpunim me këshillin e mësuesve, shqyrton rregullisht mbingarkesën e mundshme të nxënësve.				
	1.7.6. Drejtuesit zhvillojnë parateste me nxënësit e klasave të pesta/të nënta/të dymbëdhjeta.				
	1.7.7. Drejtuesit analizojnë periodikisht rezultatet e nxënësve.				
	1.7.8. Drejtori nxit zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për menaxhimin e institucionit dhe zhvillimin e kurrikulës.				
	1.7.9. Drejtuesit vëzhgojnë orë të kujdestarisë, mbledhje të ekipeve lëndore, takime të mësuesve kujdestarë me prindërit, veprimtari jashtëkurrikulare etj.				
	1.7.10. Drejtuesit zhvillojnë pyetësorë me nxënës/mësues/prindër, për të vlerësuar aspekte të ndryshme të procesit mësimor.				
	1.7.11. Drejtori kryen vlerësimin e të gjithë mësuesve, bazuar në “Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe lëndor të mësuesit në AMU e AML”, analizat e vlerësimit të arritjeve dhe kriteret zyrtare.				
1.8. Drejtori siguron transparencën e arritjeve të shkollës për prindërit e komunitetin, nëpërmjet plotësisë të saktë të Kartës së Performancës.	1.7.12. Drejtori diskuton vlerësimin e punës me secilin mësues, duke analizuar pikat e forta dhe mangësitë, për përmirësimin e punës së tij dhe cilësinë e shkollës.				
	1.8.1. Shkolla plotëson Kartën e Performancës në afatin e parashikuar në udhëzimin zyrtar.				
	1.8.2. Shkolla llogarit saktë dhe në përputhje me udhëzuesin zyrtar, treguesit e Kartës së Performancës.				
	1.8.3. Shkolla pasqyron rezultatet e pyetësorëve ³ të zhvilluar me nxënësit, mësuesit dhe prindërit, për vlerësimin e cilësisë së shërbimit arsimor.				
	1.8.4. Drejtori analizon të dhënat krahasuese të treguesve në nivel shkolle/lokal, për përcaktimin e synimeve të planit vjetor të shkollës.				
1.9. Drejtori mundëson zhvillimin e vazhdueshëm	1.8.5. Shkolla informon prindërit, nxënësit dhe komunitetin mbi rezultatet e Kartës së Performancës.				
	1.9.1. Drejtori disponon dosjet e plotësuar me dokumentacionin përkatës për të gjithë mësuesit.				
	1.9.2. Drejtori harton planin e zhvillimit të brendshëm profesional, bazuar në nevojat reale të stafit.				
	1.9.3. Drejtori krijon klimën e bashkëpunimit dhe respektit me mësuesit, në përputhje me kodin e etikës së mësuesit.				

³ Ky përshkrues praktik aplikohet, nëse ZVAP-ja ka realizuar pyetësorët në shkollë.

profesional të stafit pedagogjik, në funksion të përmirësimit të zbatimit të kurrikulës, të mësimdhënies dhe të të nxënit të suksesshëm.	1.9.4. Drejtori merr pjesë në procesin e zhvillimit profesional në nivel institucioni, për shndërrimin e stafit në një organizatë të nxëni.				
	1.9.5. Drejtori siguron programe trajnimi për stafin, në bashkëpunim me ZVAP-në, donatorë të arsimit, universitetet ose OJF-të e akredituara, ekspertë në fushën e arsimit etj.				
	1.9.6. Drejtori dhe stafi mësimdhënës marrin pjesë në rrjetet profesionale, duke përhapur përvojën dhe risitë me kolegët.				
	1.9.7. Drejtori ka ngritur ekipet lëndore me mësues të së njëjtës lëndë/fushë, sipas udhëzimeve zyrtare.				
	1.9.8. Drejtori nxit ekipet lëndore drejt një kulture vlerësimi, njohjeje dhe përmirësimi të vazhdueshëm, duke promovuar vlerat dhe vizionin e tij.				
	1.9.9. Ekipet lëndore realizojnë detyrat e tyre, sipas planit përkatës.				
	1.9.10. Ekipet lëndore bashkëpunojnë me mësues të shkollës së tyre ose të shkollave të tjera dhe specialistë të vlerësimit të kurrikulës në kuadër të rrjeteve profesionale.				
1.10. Drejtori ndërton marrëdhënie të ndërsjella partneriteti mes shkollës dhe komunitetit, për edukimin cilësor të të gjithë nxënësve.	1.10.1. Drejtori identifikon grupet e interesit dhe pritshmëritë e tyre, për të mbështetur qëllimet dhe vlerat e shkollës.				
	1.10.2. Drejtori bashkëpunon me partnerë dhe grupe interesi për projekte dhe veprimtari të përbashkëta, për të siguruar zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve/nxënësve.				
	1.10.3. Shkolla planifikon veprimtari për përfshirjen e komunitetit në jetën e shkollës, duke ofruar mjediset dhe materialet e saj për nevojat e tyre.				
	1.10.4. Drejtori bashkëpunon me organizma shtetërorë të shëndetit e të kujdesit shoqëror, policinë, qeverisjen lokale, si dhe ish-nxënës, për të mbështetur zhvillimin e shkollës.				
	1.10.5. Drejtori ka krijuar klimë pozitive dhe profesionale mes stafit dhe grupeve të interesit.				
	1.10.6. Drejtori analizon efektivitetin e bashkëpunimit shkollë-komunitet për përmirësimin e vazhdueshëm të shkollës.				
1.11. Drejtori ka ngritur organizmat e shkollës, për ndërtimin e një mjedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm.	1.11.1. Drejtori ka ngritur organizmat e shkollës ⁴ sipas procedurave të parashikuara në udhëzimet zyrtare.				
	1.11.2. Nxënësit, prindërit, mësuesit e aktorët e tjerë janë të përfshirë me përfaqësi në organizmat e shkollës.				
	1.11.3. Organizmat e shkollës kanë hartuar rregulloret për funksionimin e tyre dhe planet e punës.				
	1.11.4. Organizmat e shkollës realizojnë detyrat e përgjegjësitë e tyre sipas udhëzimeve zyrtare.				
	1.11.5. Drejtori realizon detyrat e tij për funksionimin efektiv të secilit organizëm të shkollës.				
1.12. Drejtori administron dokumentacionin shkollor në ruajtje të përhershme/ të përkohshme dhe bazën materiale, në përputhje me aktet/rregulloret përkatëse.	1.12.1. Shkolla disponon të gjithë dokumentacionin shkollor në ruajtje të përhershme dhe të përkohshme.				
	1.12.2. Shkolla plotëson amzën, indeksin e amzës dhe regjistrin e veçantë, në përputhje me udhëzimet që jepen në faqen e parë të amzës.				
	1.12.3. Shkolla administron regjistrat e klasave në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.				
	1.12.4. Shkolla plotëson të gjitha dokumentet e tjera shkollore, në përputhje me udhëzimet përkatëse.				
	1.12.5. Shkolla bashkëpunon me ZVAP-në për sigurimin e materialeve mësimore didaktike, literaturën artistike, profesionale dhe shkencore, në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit.				
	1.12.6. Shkolla siguron mjete mësimore didaktike në bashkëpunim me nxënësit, prindërit dhe komunitetin.				
	1.12.7. Drejtori ka ngritur komisionet për administrimin e inventarit sipas udhëzimeve zyrtare.				
	1.12.8. Komisionet për administrimin e inventarit e administrojnë atë në përputhje me udhëzimet zyrtare.				

⁴ Organizmat e shkollës janë: bordi i shkollës, qeveria e nxënësve, këshilli i mësuesve, këshilli i prindërve të shkollës, këshilli i prindërve të klasës, komisioni i disiplinës, komisioni i etikës dhe sjelljes, komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit, komisioni i këshillimit të karrierës.

FUSHA 2. CILËSIA E MËSIMDHËNIES DHE E TË NXËNIT

Shkolla, sot, synon ndërtimin dhe krijimin e dijes së nxënësit, për t'u përshtatur me kërkesat e standardet e reja të kohës, si qytetar i së ardhmes, që kontribuon në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë, duke u përballur në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës. Shkolla është e drejtuar drejt një procesi të hapur, si një dukuri e cila lidhet me përmbajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të të nxënës, proces gjatë të cilit, nxënës, mësuesit dhe prindërit janë njëherësh autorë dhe aktorë të tij.

Shkolla ndjek ritmet e rritjes individuale të nxënësve duke emancipuar, përmes përfshirjes së tyre në këtë proces të përfitimit dhe përpunimit të informacionit të ri, përdorimit të teknologjive të reja, si dhe njohjes dhe integritit me zhvillimet globale e më gjerë.

Mësimdhënia dhe të nxënës është një akt fleksibël, dinamik dhe bashkëveprues, mes mësuesit dhe nxënësve, ku të gjithë kanë të drejtë të marrin vendime dhe role të përshtatshme. Mësimdhënia nuk mund të ndahet nga të nxënës dhe nuk duhet kuptuar si një përbërës formal, por duhet që të dyja bashkë, të sigurojnë rritjen e cilësisë të të nxënës për të gjithë nxënës. Mësimdhënia dhe të nxënës përcjell te nxënës atë informacion dhe ato veprimtari, të cilat në kontekstin e tyre, janë në koherencë me zhvillimet sociale të shoqërisë. Mësimdhënia efektive kërkon nga mësuesi zotërimin e qëndrueshëm të strukturës shkencore të lëndës, koncepteve themelore të saj, lidhjeve mes këtyre koncepteve dhe metodave të kërkimit shkencor të saj.

Mësuesit, nëpërmjet proceseve të planifikimit, zbatimit dhe përvetësimit të kurrikulës, u mundësojnë nxënësve mbështetje të personalizuar, duke realizuar një mësimdhënie dhe nxënie konstruktive, kontekstuale, bashkëvepruese dhe të vetënormuar, me qëllim zotërimin e kompetencave në situata arsimore e jetësore. Në këtë tip mësimdhënie, mësuesi është drejtues, lehtësues dhe këshillues në orët mësimore dhe përgjatë gjithë procesit të të nxënës.

Planifikimi dhe zbatimi i situatave të të nxënës, i veprimtarive në lidhje me rezultatet e të nxënës, i burimeve alternative të të nxënës, i detyrave individuale dhe në grup, i ndarjes së roleve sipas stileve të të nxënës, i të mësuarit me tema/projekte, i vlerësimit sipas niveleve të arritjeve janë në funksion të ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave themelore që duhet të arrihen nga të gjithë nxënës.

Partneriteti shkollë-familje-komunitet siguron më shumë mundësi, për përfshirje në veprimtari mësimore-edukative, për plotësimin e interesave e nevojave të të gjithë nxënësve, për rritjen e shkallës së të nxënës, si dhe të cilësisë së formimit arsimor. Mësimdhënia dhe të nxënës orientohet nga perspektiva dhe vështrimi drejt së ardhmes, për të ofruar mundësi më të mëdha për të gjithë nxënës, për të nxitur tek ata kapacitetet, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike.

Kriteret dhe treguesit e cilësisë së fushës: Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënit

PARIMET E KURRIKULËS	FUSHA 2: CILËSIA E MËSIMDHËNIES DHE E TË NXËNIT	
	KRITERET E CILËSISË	TREGUESIT E CILËSISË
Konceptim i gjerë dhe me bazë kompetencash	Mësuesit sigurojnë mundësi të barabarta arsimit për të gjithë nxënësit, duke realizuar një mësimdhënie dhe nxënie konstruktive, kontekstuale, bashkëvepruese dhe të vetënormuar, në situata dhe kontekste mësimore ose jetësore.	1. Planifikimi lëndor është hartuar bazuar në dokumentet kurrikulare, në pikëpamjen pedagogjike të mësuesit dhe në përshtatje me nxënësit e tij. 2. Mësuesi realizon bashkë me nxënësit projekte lëndore, ndërlëndore që i ndihmojnë nxënësit të përpunojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat kurrikulare/ndërkurrikulare. 3. Plani ditor hartohet duke identifikuar objektin/et e të nxënit dhe mënyrën e vlerësimit të nxënësit. 4. Mjedisi i të nxënit është funksional dhe motivues për të gjithë nxënësit. 5. Mësuesi dhe nxënësit përdorin një metodologji të përshtatshme për ndërtimin e zhvillimin e kompetencave. 6. Mësuesi planifikon detyra shtëpie individuale dhe në grup, si vazhdim i procesit të nxënies. 7. Mësuesi realizon vlerësimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të demonstruara nga nxënësit në kontekste të ndryshme.
Gjithëpërfshirja	Mësuesit në planifikimin, zbatimin dhe përvetësimin e kurrikulës, bazohen në nevojat vetjake, stilet e të nxënit dhe përvojat mësimore paraprake të të gjithë nxënësve, për përmirësimin e nivelit të arritjeve të tyre.	
Baraspesha dhe integrimi	Mësuesit planifikojnë dhe zbatojnë kurrikulën, duke siguruar baraspeshën mes njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të secilës fushë të nxëni, si dhe integrimin brenda dhe ndërmjet tyre, për përvetësimin e saj nga të gjithë nxënësit.	
Vijimësia	Mësuesit planifikojnë dhe zbatojnë kurrikulën, në përputhje me veçoritë kryesore të grupmoshave të nxënësve, nivelin dhe pikëmbërritjet e të nxënit në shkallë e nivele të ndryshme arsimore, duke qartësuar nxënësit dhe prindërit.	
Bashkëpunimi dhe partneriteti	Mësuesit planifikojnë dhe zbatojnë kurrikulën, duke bashkëpunuar me përgjegjësi me të gjithë aktorët dhe palët e interesuara.	
Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle, përgjegjshmëria	Mësuesit sigurojnë një mësimdhënie të individualizuar, në përshtatje të nevojave të të gjithë nxënësve me kurrikulën, për ndërtimin e zhvillimin e kompetencave themelore.	

Treguesit e cilësisë dhe përshkruesit praktikë të fushës: Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënës

FUSHA 2: CILËSIA E MËSIMDHËNIES DHE E TË NXËNIT					
TREGUESIT E CILËSISË	PËRSHKRUESIT PRAKTIKË	NIVELET E VLERËSIMIT			
		1	2	3	4
2.1. Planifikimi lëndor është hartuar bazuar në dokumentet kurrikulare, në pikëpamjen pedagogjike të mësuesit dhe në përshtatje me nxënësit e tij.	2.1.1. Mësuesi ka dorëzuar në drejtori, 5 ditë para fillimit të vitit shkollor, planin lëndor/modul vjetor dhe atë periudhës së parë.				
	2.1.2. Plani vjetor lëndor/modul dhe ai i periudhës përkatëse është shqyrtuar në ekipin lëndor përkatës.				
	2.1.3. Mësuesi ka hartuar planin lëndor vjetor sintetik, sipas formatit zyrtar.				
	2.1.4. Mësuesi ka përcaktuar shpërndarjen e kohës mësimore në planin lëndor vjetor.				
	2.1.5. Mësuesi ka përcaktuar përmbajtjen kryesore të lëndës në planin vjetor lëndor, në përputhje me programin e lëndës.				
	2.1.6. Mësuesi ka hartuar planin lëndor analitik të periudhës përkatëse, sipas formatit zyrtar.				
	2.1.7. Mësuesi ka hartuar planin lëndor të periudhës në përputhje me nevojat e nxënësve.				
	2.1.8. Mësuesi, në planin lëndor të periudhës, ka siguruar vijimësinë e lëndës në përputhje me programin lëndor.				
	2.1.9. Mësuesi ka hartuar planin lëndor të periudhës, duke përzgjedhur burime të ndryshme të nxëni.				
	2.1.10. Mësuesi, për të plotësuar nevojat e nxënësve, ndryshon planin e periudhave, duke marrë miratimin në drejtori.				
2.2. Mësuesi realizon bashkë me nxënësit projekte lëndore, ndërlëndore që i ndihmojnë nxënësit të përpunojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat kurrikulare/ndërkurrikulare.	2.2.1. Mësuesi ka planifikuar bashkë me nxënësit projekte lëndore/ndërlëndore, duke realizuar integrimin e lëndëve.				
	2.2.2. Projekti i hartuar nga mësuesi (mësuesit) ka këto elemente: - titulli i projektit; - rezultatet e te nxënës; - kontributi i çdo mësuesi (nëse në një projekt merr pjesë më shumë se një mësues); - orët mësimore që i takojnë secilit partner, nëse ka (prindër, OJF etj.); - numri i nxënësve që përfshihen në projekt ose numri i klasave; - përshkrimi përmbledhës i veprimtarive kryesore (hapat, afatet, përgjegjësit); - burimet kryesore të informacionit; - përshkrimi i produktit të projektit; - tematika e secilës orë mësimore në kuadrin e projektit; - mënyra e vlerësimit të nxënësve; - buxheti (nëse ka).				
	2.2.3. Shkolla ka bashkëpunuar me prindërit dhe komunitetin për realizimin e projekteve kurrikulare në botën reale.				
	2.2.4. Mësuesi ka qartësuar nxënësit për mënyrën dhe kriteret e vlerësimit të projektit.				
	2.2.5. Mësuesi ka përfshirë të gjithë nxënësit në projekt me një detyrë të përcaktuar qartë.				
	2.2.6. Projekti kurrikular është prezantuar para klasës ose para një audience më të gjerë.				
	2.2.7. Mësuesi ka vlerësuar çdo nxënës për projektin në kuadër të vlerësimit të portofolit.				
2.3. Plani ditor hartohet duke	2.3.1. Mësuesi harton në vijimësi planifikimin e çdo ore mësimore.				

identifikuar objektin/et e të nxënit dhe mënyrën e vlerësimit të nxënësit.	2.3.2.	Mësuesi ka hartuar planin ditor me të gjitha rubrikat e parashikuara në formatin zyrtar.				
	2.3.3.	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënit për njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të zhvillojë nxënësi gjatë orës/njesisë mësimore.				
	2.3.4.	Mësuesi ka planifikuar situatën e të nxënit (kur është e mundur), që nxënësit të ndërtojnë njohuritë e tyre.				
	2.3.5.	Mësuesi ka planifikuar veprimtari për realizimin e rezultateve të të nxënit.				
	2.3.6.	Mësuesi ka planifikuar materialet mësimore didaktike që lidhen drejtpërdrejt me arritjet e rezultateve të të nxënit.				
	2.3.7.	Mësuesi ka planifikuar detyra klase, individuale dhe në grup, sipas stileve të të nxënit.				
	2.3.8.	Mësuesi ka planifikuar pyetje që u përgjigjen të gjitha niveleve të të menduarit të nxënësit.				
	2.3.9.	Mësuesi ka planifikuar veprimtari të diferencuara për nxënësit me nevoja të veçanta.				
	2.3.10.	Mësuesi ka përcaktuar, herë pas here, nxënësit që do të vlerësojë, duke identifikuar teknikat e përshtatshme të vlerësimit.				
	2.3.11.	Mësuesi ka planifikuar detyra/punë të pavarura ⁵ shtëpie, që synojnë ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave.				
	2.3.12.	Mësuesi, herë pas here, planifikon një kohë reflektimi për vetëvlerësimin, vlerësimin e ndërsjellë dhe për t'u dhënë nxënësve informacionin për vlerësimin e të nxënit.				
2.4. Mjedisi i të nxënit është funksional dhe motivues për të gjithë nxënësit.	2.4.1.	Mësuesi ka krijuar një mjedis të brendshëm/të jashtëm funksional dhe të përshtatshëm ndaj nevojave të nxënësve, për të lehtësuar të nxënit.				
	2.4.2.	Mësuesi paraqet në vende të dukshme produktet individuale të nxënësve, të ekipeve të vogla apo të klasës.				
	2.4.3.	Mësuesi siguron që secili nxënës të ndihet i lirshëm për të shprehur atë që mendon dhe mëson.				
	2.4.4.	Mësuesi, bashkë me nxënësit, ka hartuar rregullat e klasës.				
	2.4.5.	Mësuesi ka të dokumentuar identifikimin e stileve të të nxënit të nxënësve të klasës.				
	2.4.6.	Mësuesi krijon një atmosferë gjithëpërfshirëse, për ndërtimin e marrëdhënieve pozitive mes nxënësve, që ata të dëgjojnë dhe të vlerësojnë opinionet e njëri-tjetrit.				
	2.4.7.	Mësuesi ka krijuar një mjedis që nxit nxënësit të ndërmarrin iniciativa, duke qenë tolerantë ndaj gabimeve të të tjerëve.				
	2.4.8.	Mësuesi është konfidencial me nxënësit, duke arsyetuar për mbetjen prapa apo suksesin.				
	2.4.9.	Mësuesi promovon sjellje pozitive të nxënësve të klasës, duke mos anashkuar sjelljet jonormale të tyre.				
2.5. Mësuesi dhe nxënësit përdorin një metodologji të përshtatshme për ndërtimin e zhvillimin e kompetencave.	2.5.1.	Mësuesi informon nxënësit për rezultatet e të nxënit në fillim të orës/njesisë mësimore.				
	2.5.2.	Mësuesi realizon me nxënësit situata të të nxënit, reale ose të ngjashme me realitetin, duke e vënë theksin te konteksti dhe zbatimi i njohurive, për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave.				
	2.5.3.	Mësuesi shpjegon qartë, duke mbajtur parasysh nevojat vetjake, stilet e të nxënit, si dhe përvojat mësimore paraprake të nxënësve				
	2.5.4.	Mësuesi realizon strategji të të pyeturit (pyetje të hapura ⁶ /të mbyllura/me alternativë) që zhvillojnë te nxënësi aftësi të të menduarit të nivelit të lartë në përgjigjet e tyre.				
	2.5.5.	Mësuesi përdor risitë shkencore që i përkasin lëndës.				
	2.5.6.	Nxënësit zhvillojnë veprimtari të diferencuara sipas nivelit dhe nevojave të tyre.				

⁵Mundësisht, sipas rastit, këto detyra të jenë të integruara brenda fushës apo ndërmjet fushave.

⁶ Sidomos pyetje me “Si” dhe “Pse”.

	2.5.7.	Mësuesi formon grupe të ndryshme nxënësish, të tilla si: – grupe të bazuara në nevoja; – grupe të bazuara në interesa.				
	2.5.8.	Mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, përcakton kohën për përfundimin e çdo detyrë dhe veprimtarie.				
	2.5.9.	Nxënësit zbatojnë rolet e caktuara nga mësuesi ose ato të vetëzgjedhura në punën në grup.				
	2.5.10.	Nxënësit i bëjnë pyetje njëri-tjetrit, duke shkëmbyer ide dhe duke pranuar mendimin ndryshe.				
	2.5.11.	Mësuesit dhe nxënësit përdorin terminologjinë e fushës/lëndës përkatëse, për ndërtimin e zhvillimin e kompetencave.				
	2.5.12.	Nxënësit shkruajnë herë pas here ese, referate, detyra përmbledhëse, për të zhvilluar shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat.				
	2.5.13.	Nxënësit integrojnë njohuritë e marra në lëndë të ndryshme, për të zgjidhur probleme të ndryshme.				
	2.5.14.	Nxënësit korrigjojnë gabimet e njëri-tjetrit, duke shmangur keqkuptimet.				
	2.5.15.	Mësuesi dhe nxënësit përdorin gjuhën shqipe standarde.				
	2.5.16.	Mësuesi menaxhon nxënësit dhe kohën në mënyrë efektive.				
	2.5.17.	Mësuesi dhe nxënësit përdorin me efektivitet teknologjitë e informacionit (laptop/videoprojektor) dhe mjetet/materialet didaktike.				
	2.5.18.	Mësuesi e zhvillon orën e mësimit ⁷ në laboratorin/kabinetin përkatës, për arritjen e rezultateve të të nxënësit në përputhje me programin (orët laboratorike, eksperimente, orët praktike, TIK-un, prezantime të ndryshme etj.).				
2.6.	2.5.19.	Mësuesi i edukimit fizik e shëndetësor e zhvillon orën mësimore në mjediset sportive të brendshme/të jashtme.				
	2.5.20.	Mësuesi dhe nxënësit, në fund të orës mësimore, kanë nxjerrë përfundimet ose japin “feedback” ⁸ -un.				
	2.6.1.	Mësuesi u jep nxënësve detyra individuale/në grup, duke i sqaruar ato në fund të orës mësimore.				
	2.6.2.	Mësuesi u jep mundësi nxënësve herë pas here, që të përzgjedhin vetë kërkesat për detyrat e shtëpisë.				
	2.6.3.	Mësuesi jep detyra që përmbajnë koncepte të njohura për nxënësin.				
2.7	2.6.4	Mësuesi përcakton detyra të personalizuar në përputhje me rezultatet e të nxënësit.				
	2.6.5	Mësuesi planifikon, herë pas here, detyra me kërkesa për përdorimin e TIK-ut.				
	2.7.1.	Mësuesi vlerëson herë pas here arritjet e rezultateve të të nxënësit të orës/njësisë mësimore.				
	2.7.2.	Mësuesi informon nxënësit për kriteret e përcaktuara për vlerësimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve.				
	2.7.3.	Mësuesi ka vlerësuar nxënësit për njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara për vlerësim.				
	2.7.4.	Mësuesi ndihmës ka vlerësuar nxënësit me nevoja të veçanta (nëse ka të tillë), në përputhje me PEI-in.				
	2.7.5.	Nxënësit vetëvlerësojnë herë pas here arritjet e të nxënësit, për përmirësim të vazhdueshëm.				
	2.7.6.	Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin, herë pas here, për arritjet e të nxënësit.				
	2.7.7.	Mësuesi vlerëson rregullisht detyrat e klasës/shtëpisë/punës në grup, duke argumentuar vlerësimin e dhënë.				

⁷ Ky përshkrues përdoret për vlerësim nëse shkolla ka laboratorët përkatës.

⁸ Llojet e “feedback”-ut jepen te pjesa “Përkufizime”.

FUSHA 3. VLERËSIMI DHE ARRITJET E NXËNËSVE

Vlerësimi është proces i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës që kërkon një planifikim të kujdesshëm dhe zbatim sistematik, të mbështetur në të dhëna reale dhe evidenca të sakta, që tregojnë nivelin e arritjes së rezultateve të të nxënit për lëndë/fushë në një shkallë të caktuar, të përcaktuara në kurrikulën bërthamë dhe në planet e programet mësimore.

Vlerësimi i nxënësve përshkon gjithë procesin mësimor dhe tregon dy anë të mësimdhënies: a) nevojat e nxënësve për të nxënë dhe b) arritjet e tyre. Qëllimi kryesor i vlerësimit është gjykimi i mësuesit mbi arritjet e nxënësit për kurrikulën e përvetësuar, si dhe mbështetjen e të nxënit dhe të përparimit të tij, duke synuar një kombinim të vlerësimit për të nxënë me vlerësimin e të nxënit.

Vlerësimi mbështet përmbushjen e kompetencave themelore, të rezultateve lëndore dhe formave të tjera të kësaj kurrikule, si projekte lëndore/ndërlëndore dhe aftësitë ndërkurrikulare. Ai bazohet tërësisht te kërkesat e udhëzuesve të ndryshëm, të programeve lëndore dhe ndikon në marrjen e vendimeve që synojnë përmirësimin e rezultateve të të nxënit të fushës dhe të kompetencave themelore, si dhe vetë procesin e vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet në parime që e bëjnë atë një aktivitet të planifikuar, të vazhdueshëm dhe pjesë integrale të praktikave më të mira të procesit të mësimdhënies dhe të nxënies. Ai drejton të nxënit e nxënësve dhe nuk ka për qëllim të vetëm notën e as përfundon me vendosjen e saj. Vlerësimi që kryhet pas përfundimit të procesit mësimor, synon të japë përfundimet për arritjet e nxënësve, përparimin e tyre, si dhe ndihmon në marrjen e vendimeve për përmirësimin e mësimdhënies dhe të të nxënit.

Kriteret dhe treguesit e cilësisë së fushës: Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve

PARIMET E KURRIKULËS	FUSHA 3: VLERËSIMI DHE ARRITJET E NXËNËSVE	
	KRITERET E CILËSISË	TREGUESIT E CILËSISË
Konceptim i gjerë dhe me bazë kompetencash	Arritjet dhe progresi i nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore, plotësojnë pritshmëritë e vendosura në kurrikulën bërthamë.	1. Mësuesi vlerëson vazhdimisht progresin e nxënësit. 2. Mësuesi vlerëson nxënësin duke u bazuar te portofoli i tij. 3. Mësuesi mat nivelin e arritjeve të nxënësit me anë të testeve/detyrave përmbledhëse. 4. Mësuesi bën vlerësimin periodik të nxënësit në fund të çdo periudhe. 5. Mësuesi kryen vlerësimin vjetor dhe vlerësimin përfundimtar të nxënësit. 6. Mësuesi informon prindërit për rezultatet e nxënësve. 7. Shkolla kryen rivlerësimin e nxënësve. 8. Rezultatet e nxënësve në vlerësimin kombëtar të klasës së pestë, përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga shkolla. 9. Rezultatet e nxënësve në Provimet e Lirimit, përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga shkolla. 10. Rezultatet e nxënësve në Maturën Shtetërore, përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga vetë shkolla. 11. Arritjet e nxënësve përputhen me pritshmëritë e shkollës.
Gjithëpërfshirja	Shkolla siguron kushte, në mënyrë që nxënësit të nxënë dhe të ushtrojnë përgjegjësitë e veta sociale e qytetare në klasë, në shkollë dhe në komunitet.	
Baraspesha dhe integrim	Arritjet dhe progresi i nxënësve në zotërimin e rezultateve për fushat kurrikulare, ruajnë baraspeshën ndërmjet njohurive, shkathësive qëndrimeve të secilës fushë të nxëni, si dhe integrimin brenda dhe ndërmjet tyre.	
Vijimësia	Arritjet dhe progresi i nxënësit në të nxënë bëhen duke i ndërtuar njohuritë e reja, mbi bazën e njohurive dhe përvojës së tyre të mëparshme.	
Bashkëpunimi dhe partneriteti	Shkolla mundëson bashkëpunim të përgjegjshëm të të gjithë aktorëve dhe palëve të interesuara, për të rritur progresin e nxënësve.	
Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle, përgjegjshmëria	Nxënësit angazhohen në aktivitete ekstrakurrikulare, të cilat ndikojnë në procesin e nxënies dhe rritjen e nivelit të arritjeve të tyre.	

Treguesit e cilësisë dhe përshkruesit praktikë të fushës: Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve

FUSHA 3: VLERËSIMI DHE ARRITJET E NXËNËSVE							
TREGUESIT E CILËSISË	PËRSHKRUESIT PRAKTIKË	NIVELET E VLERËSIMIT					
		1	2	3	4		
3.1. Mësuesi vlerëson vazhdimisht progresin e nxënësit.	3.1.1. Mësuesi vlerëson progresin e nxënësit për përgjigjet me gojë/me shkrim, punët në grup, detyrat e shtëpisë dhe të klasës, diskutimet e nxënësve, vetëvlerësimin e nxënësit, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debate të ndryshme.						
	3.1.2. Mësuesi dokumenton vlerësimin e vazhduar me anë të simboleve dhe niveleve të arritjeve të vendosura në evidencën personale.						
	3.1.3. Mësuesi i klasave I-III vlerëson detyrat dhe punimet e nxënësit vetëm me shprehje vlerësuese.						
	3.1.4. Mësuesi zhvillon teste/detyra të ndërmjetme për vlerësimin e nxënësit, sipas kërkesave të kurrikulës përkatëse.						
	3.1.5. Mësuesi ruan evidencën e vlerësimit të vazhduar deri në fund vitit shkollor.						
3.2. Mësuesi vlerëson nxënësin duke u bazuar te portofoli i tij.	3.2.1. Mësuesi përcakton rezultatet e të nxënës që do të realizohen nëpërmjet produkteve të portofolit të nxënësit.						
	3.2.2. Në fillim të periudhës, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, përcakton detyrat që do të përfshihen në portofol përgjatë periudhës.						
	3.2.3. Mësuesi përcakton kriteret për vlerësimin e materialeve/punimeve të portofolit të nxënësit.						
	3.2.4. Mësuesi vlerëson detyrat e portofolit apo një fazë të projektit në momentin që ato dorëzohen ose prezantohen nga nxënësi.						
	3.2.5. Mësuesi i klasave IV-XII vlerëson me notë të veçantë portofolin e nxënësit, në fund të çdo periudhe.						
3.3. Mësuesi mat nivelin e arritjeve të nxënësit me anë të testeve/detyrave përmbledhëse.	3.3.1. Mësuesi zhvillon një test/detyrë përmbledhëse në përfundim të çdo periudhe.						
	3.3.2. Mësuesi pasqyron notat e testit me short në regjistër, në kolonën e vlerësimit të testeve.						
	3.3.3. Testi/detyra përmbledhëse mat një grup të caktuar rezultatesh të nxënë, të kompetencave të ndryshme, për një periudhë të caktuar.						
	3.3.4. Testi përmban pyetje objektive, subjektive ose të kombinuara.						
	3.3.5. Testi ka pyetje për nivele të ndryshme arritjeje.						
	3.3.6. Testi nuk ka pyetje të diskriminimit social, gjinor, racor etj.						
	3.3.7. Testi ka një pikëzim të qartë për çdo pyetje.						
	3.3.8. Testi ka tabelë vlerësimi.						
	3.3.9. Mësuesi ka hartuar skemën e vlerësimit të testit.						
	3.3.10. Mësuesi i klasave IV-XII vlerëson testin/detyrën përmbledhëse me notë të veçantë, në fund të çdo periudhe.						
	3.3.11. Mësuesi i ruan testet/detyrat përmbledhëse gjatë një viti shkollor.						
3.4. Mësuesi bën vlerësimin periodik të nxënësit në	3.4.1. Mësuesi i klasave I-III pasqyron në regjistër arritjet e kompetencave të lëndës/fushës së të nxënës, për periudhën përkatëse, nëpërmjet 5 niveleve të vlerësimit.						

fund të çdo periudhe.	3.4.2. Mësuesi i klasave IV-XII pasqyron në regjistër me nota të veçanta arritjet e nxënësit, për vlerësimin e vazhduar, testin/detyrën përmbledhëse dhe portofolin, në fund të çdo periudhe.				
3.5. Mësuesi kryen vlerësimin vjetor dhe vlerësimin përfundimtar të nxënësit.	3.5.1. Vlerësimet vjetore përmbajnë notat vjetore të vlerësimit të vazhduar, të testit/detyrës përmbledhëse dhe të portofolit të nxënësit për të tri periudhat.				
	3.5.2. Mësuesi i klasave IV-XII bën vlerësim vjetor progresiv/regresiv, kur ecuria e nxënësit është progresive/regresive gjatë dy periudhave të fundit.				
	3.5.3. Mësuesi i klasave IV-XII llogarit me mesatare aritmetike vlerësimin vjetor, kur ecuria e nxënësit nuk është e qëndrueshme përgjatë tri periudhave.				
	3.5.4. Mësuesi kryen vlerësimin përfundimtar, pasi ka bërë vlerësimet vjetore.				
	3.5.5. Mësuesi llogarit notën përfundimtare, duke respektuar përqindjet e përcaktuara për të tri vlerësimet vjetore.				
	3.5.6. Mësuesi i klasave IV-XII bën vlerësimin përfundimtar në regjistër me notë.				
	3.5.7. Mësuesi i klasave I-III bën vlerësimin përfundimtar, duke përdorur kodet (1-5) dhe simbolin e nivelit të vlerësimit (APK, ANP, AK, ASHK, ASH).				
	3.5.8. Mësuesi i klasave I-III pasqyron në regjistër, në rubrikën “Vlerësimi përmbledhës”, arritjet e nxënësit për kompetencat e lëndës/fushës, si dhe vlerësimin përfundimtar.				
3.6. Mësuesi informon prindërit për rezultatet e nxënësve.	3.6.1. Mësuesi raporton me shkrim te prindërit vlerësimet periodike të nxënësve në përfundim të çdo periudhe.				
	3.6.2. Raportimi i arritjeve të nxënësit mbështetet tek evidencat, testi/detyra përmbledhëse dhe portofoli i nxënësit.				
3.7. Shkolla kryen rivlerësimin e nxënësve.	3.7.1. Shkolla ka procedura të qarta për rivlerësimin e nxënësit në sesionin e dytë.				
	3.7.2. Mësuesi i klasave IV-V bën rivlerësimin e nxënësit, bazuar te detyrat e zhvilluara gjatë verës.				
	3.7.3. Mësuesi i klasave VI-XII harton programin orientues dhe detyrat konkrete, për t’u përgatitur nga nxënësi në periudhën e verës.				
	3.7.4. Mësuesi i klasave VI-XII bën rivlerësimin e nxënësit në sesionin e dytë, nëpërmjet provimit me shkrim.				
3.8. Rezultatet e nxënësve në vlerësimin kombëtar të klasës së pestë, përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga shkolla.	3.8.1. Shkolla ka të dokumentuara arritjet e nxënësve në vlerësimet kombëtare.				
	3.8.2. Shkolla krahason arritjet vjetore të nxënësve me ato të vlerësimeve kombëtare.				
	3.8.3. Shkolla analizon arritjet e nxënësve, duke nxjerrë pikat e forta dhe të dobëta.				
	3.8.4. Rezultatet tregojnë një përputhje të kënaqshme të vlerësimit të bërë nga shkolla, me vlerësimin e jashtëm të testimit të klasave të pesta.				
	3.8.5. Shkolla ka hartuar plane përmirësimi, bazuar te mangësitë dhe arritjet e konstatuara, pas analizës së rezultateve.				
3.9. Rezultatet e nxënësve në Provimet e Lirimit, përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga shkolla.	3.9.1. Shkolla ka të dokumentuara arritjet e nxënësve në Provimet e Lirimit.				
	3.9.2. Shkolla krahason arritjet vjetore të nxënësve me ato të Provimeve të Lirimit.				
	3.9.3. Shkolla analizon arritjet e nxënësve në provime, duke nxjerrë pikat e forta dhe të dobëta.				
	3.9.4. Rezultatet tregojnë një përputhje të kënaqshme të vlerësimit të bërë nga shkolla, me vlerësimin e jashtëm të Provimeve të Lirimit.				
	3.9.5. Shkolla harton plane përmirësimi, bazuar te mangësitë dhe arritjet e konstatuara, pas analizës së rezultateve.				
3.10. Rezultatet e nxënësve në Maturën Shtetërore,	3.10.1. Shkolla ka të dokumentuara arritjet e nxënësve në Maturën Shtetërore.				
	3.10.2. Shkolla krahason arritjet vjetore të nxënësve me ato të Maturës Shtetërore.				

përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga vetë shkolla.	3.10.3. Shkolla analizon arritjet e nxënësve në Maturën Shtetërore, duke nxjerrë pikat e forta dhe të dobëta.				
	3.10.4. Rezultatet tregojnë një përputhje të kënaqshme të vlerësimit të bërë nga shkolla, me vlerësimin e jashtëm të provimeve të Maturës Shtetërore.				
	3.10.5. Shkolla harton plane përmirësimi, bazuar te mangësitë dhe arritjet e konstatuara pas analizës.				
3.11. Arritjet e nxënësve përputhen me pritshmëritë e shkollës.	3.11.1. Nxënësit, në 3 vite, marrin rezultate që priten prej tyre (kalueshmëria dhe cilësia e kalueshmërisë si shkollë).				
	3.11.2. Nxënësit, në fund të vitit shkollor, arrijnë rezultatet e pritshme prej tyre në të gjitha lëndët (kalueshmëria dhe cilësia e kalueshmërisë si shkollë).				
	3.11.3. Nxënësit, në 3 vite, marrin rezultate që priten prej tyre, në provimet/vlerësimet kombëtare (kalueshmëria dhe cilësia e kalueshmërisë në lëndët që jepen provim).				
	3.11.4. Nxënësit marrin rezultate që priten prej tyre, në vlerësimin e arritjeve të tyre në arsimin fillor (kalueshmëria dhe cilësia e kalueshmërisë në vlerësimin për klasën e pestë, VANAF-i).				
	3.11.5. Nxënësit marrin rezultate që priten prej tyre në Provimet e Lirimit/Maturës Shtetërore (kalueshmëria dhe cilësia e kalueshmërisë në lëndët që jepen provim).				
	3.11.6. Përqindja e grupnotave 5-6, 7-8, 9-10 për të gjithë nxënësit në Provimet e Lirimit/Maturës Shtetërore, përputhet me përqindjen e këtyre grupnotave në përfundimet vjetore të tyre.				
	3.11.7. Nxënësit marrin rezultate që priten prej tyre, në provimet me short që organizon drejtorja e shkollës.				
	3.11.8. Nxënësit marrin rezultate që priten prej tyre, në provimet që organizon ZVAP-ja/DRAP-i ⁹				
	3.11.9. Nxënësit marrin rezultate që priten prej tyre, në provimet ndërkombëtare. ¹⁰				
	3.11.10. Shkolla ka fituar çmime në olimpiada, projekte, gara të ndryshme ndërmjet shkollash, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.				
	3.11.11. Shkolla rankohet mbi mesataren rajonale për treguesit e arritjeve të nxënësve në Kartën e Performancës.				

⁹ Ky përshkrues praktik vlerësohet, nëse shkolla përfshihet në provimet e ZVAP-së/DRAP-it.

¹⁰ Ky përshkrues praktik vlerësohet, nëse shkolla është e përfshirë në provimet ndërkombëtare.

FUSHA 4. MIRËQENIA DHE SJELLJA E NXËNËSVE

Mirëqenia e nxënësit në tërësi, është një ndjesi shumëdimensionale që përfshin aspekte të mirëqenies shpirtërore, fizike, sociale, emocionale, angazhuese dhe materiale. Shkolla është një mjedis ku nxënësit kalojnë një pjesë të madhe të kohës, si e tillë ajo duhet të ofrojë një atmosferë mikpritëse, që të krijojë mundësi shoqërizimi dhe përkatësie. Kushtet fizike të shkollës duhet të jenë të sigurta dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor edukativ, si dhe konsolidimin e aftësive dhe kompetencave të nxënësit. Për më tepër, mjediset e shkollës nevojiten që të jenë ftuese dhe edukuese, me qëllim motivimin e nxënësve dhe zhvillimin e shijeve estetike.

Mbështetja e nxënësit është përmbushja e nevojave dhe prirjeve të tij, çka nënkupton ofertën që paraqet shkolla në lëndët që zhvillon, si dhe larminë e veprimtarive ekstrakurrikulare, të cilat duhet të përkujnë me veçoritë dhe interesat e nxënësit. Një tjetër komponent i rëndësishëm fokusohet te mbështetja emocionale dhe zhvillimi i potencialit të nxënësit, në mënyrë të veçantë për nxënësit me nevoja ndryshe dhe ata me talente në fusha të ndryshme. Shkolla punon për të krijuar identitetin e saj, duke ofruar module që lidhen me zhvillimin lokal dhe promovimin e traditave të rajoneve shqiptare.

Një klimë miqësore dhe e shëndetshme ndikon në ndjesinë e aktorëve të angazhuar në shkollë, në motivimin e tyre për zhvillim në aspektin akademik dhe atë social. Një njohje e mirë e nxënësit nga shkolla, bën që ai të marrë mbështetjen e duhur. Shkolla duhet të kujdeset që nxënësi të ndihet mirë, pavarësisht nga përkatësia gjinore, etnike, fetare, seksuale apo nevojave të veçanta që mund të paraqesë. Theksojmë se ofrimi i shërbimit psiko-social ndikon në përparimin dhe integrimin e nxënësit në jetën e shkollës.

Shkolla ndihmon nxënësin për të zgjidhur probleme të ndryshme psikologjike, sociale etj., si dhe angazhohet në bashkëpunim të ngushtë me familjen, për një komunikim etik. Për rritjen e mirëqenies së nxënësit shkolla gjithashtu, punon në drejtim të konsolidimit të të nxënësit, vetëbesimit dhe vetëvlerësimit të nxënësit. Shkolla siguron që nxënësit të trajtohen në mënyrë të drejtë, gjithëpërfshirëse, të vetëdijesohen për të drejtat dhe detyrat e tyre, si dhe të inkurajohen të respektojnë dhe kuptojnë pikëpamjet e të tjerëve.

Për të siguruar mirëqenien e nxënësve, shkolla bashkëpunon ngushtë me partnerë që e vlerësojnë edukimin dhe janë të gatshëm të ndihmojnë për çuarjen e tij përpara. Në këtë kontekst, ajo përpaket të ngrejë ura komunikimi dhe bashkëpunimi me aktorë të interesuar dhe institucione që ndikojnë në zhvillimin e saj. Shkolla mban lidhje të forta me prindërit, duke i informuar në vijimësi mbi aktivitetet, projektet dhe progresin e nxënësve, por dhe duke u ofruar zgjidhje mbi vështirësitë dhe sfidat me të cilat ata përballen. Nga ana tjetër, shkolla përpaket të rrisë ndërgjegjësimin e nxënësve mbi nevojat e komunitetit, me qëllim fuqizimin e ndërsjellë, si dhe të ofrojë ndihmë për zhvillimin dhe integrimin e komunitetit.

Klima në shkollë, motivimi, marrëdhëniet e shëndetshme mbeten faktorë parësorë në mbarëvajtjen e suksesit akademik, si dhe mirëqenien psiko-sociale të nxënësit. Si e tillë, shkolla kërkon angazhimin dhe seriozitetin e të gjithë aktorëve, që të kontribuojnë në mirëqenien dhe sjelljen e nxënësve.

Kriteret dhe treguesit e cilësisë së fushës: Mirëqenia dhe sjellja e nxënësve

PARIMET E KURRIKULËS	FUSHA 4: MIRËQENIA DHE SJELLJA E NXËNËSVE	
	KRITERET E CILËSISË	TREGUESIT E CILËSISË
Konceptim i gjerë dhe me bazë kompetencash	Shkolla siguron mjedise mësimore të sigurta, të përshtatshme dhe ftuese, në funksion të zotërimit të kompetencave themelore nga të gjithë nxënësit.	1. Shkolla ofron mjedise fizike dhe mësimore të përshtatshme, që sigurojnë mirëqenien e të gjithë nxënësve. 2. Shkolla ofron mbështetje emocionale, sociale dhe akademike për të gjithë nxënësit. 3. Shkolla mbështet nxënësit me nevoja të veçanta. 4. Shkolla u garanton nxënësve të drejtat dhe ushtrimin e detyrave të tyre. 5. Psikologu/punonjësi social kontribuon për mirëqenien e të gjithë individëve dhe grupeve në shkollë. 6. Oficeri i sigurisë kontribuon në krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë dhe përreth saj. 7. Shkolla ndërvepron me prindërit dhe komunitetin për përmirësimin e mirëqenies në shkollë.
Gjithëpërfshirja	Shkolla siguron përfshirjen e të gjithë nxënësve në veprimtaritë mësimore-edukative për rritjen e mirëqenies.	
Baraspesha dhe integrim	Mësuesit sigurojnë strategji të mësimdhënies dhe të nxënies, të cilat nxisin zhvillimin akademik, emocional dhe social të të gjithë nxënësve.	
Vijimësia	Shkolla u mundëson nxënësve kalimin në nivele të ndryshme, duke u dhënë mbështetje emocionale, sociale dhe akademike, për rritjen e potencialit të tyre.	
Bashkëpunimi dhe partneriteti	Shkolla bashkëpunon me të gjitha palët e interesuara për krijimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve fizike dhe mësimore, duke promovuar mirëqenien e çdo nxënësi.	
Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle, përgjegjshmëria	Shkolla u mundëson të gjithë nxënësve të përfshihen në veprimtari të ndryshme, sipas nevojave dhe interesave të tyre.	

Treguesit e cilësisë dhe përshkruesit praktikë të fushës: Mirëqenia dhe sjellja e nxënësve

FUSHA 4: MIRËQENIA DHE SJELLJA E NXËNËSVE

TREGUESIT E CILËSISË	PËRSHKRUESIT PRAKTIKË	NIVELET E VLERËSIMIT			
		1	2	3	4
4.1. Shkolla ofron mjedise fizike dhe mësimore të përshtatshme, që sigurojnë mirëqenien e të gjithë nxënësve.	4.1.1. Shkolla ka mjedise të sigurta dhe të përshtatshme për të gjithë nxënësit (oborri i shkollës, kangjellat, shkallët e brendshme, shkallët e emergjencës, rampa, mjete për shuarjen e zjarrit etj.).				
	4.1.2. Raporti nxënës-hapësirë është në përputhje me normat zyrtare të mjediseve fizike të shkollës.				
	4.1.3. Laboratorët, kabinetet, palestra, mjediset sportive të jashtme dhe biblioteka janë të përshtatshëm/të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore-edukative.				
	4.1.4. Shkolla ka mjedise të brendshme të ajrosura dhe të ndriçuara.				
	4.1.5. Shkolla ka ujë të rrjedhshëm, të ngrohtë, të ftohtë dhe klinikisht të pastër.				
	4.1.6. Shkolla ka sistem për ngrohjen dhe ftohjen e mjediseve.				
	4.1.7. Shkolla ka tualete të mjaftueshme, në raport me numrin e nxënësve dhe të përshtatshme për nxënësit me aftësi të kufizuara.				
	4.1.8. Shkolla mirëmban mjediset dhe kujdeset për higjienën e tyre.				
	4.1.9. Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit monitoron në vijimësi shëndetin dhe sigurinë e nxënësve, si dhe mirëmbajtjen e mjediseve të shkollës.				
	4.1.10. Shkolla afishon në mjediset e saj numrat e emergjencës (policisë, zjarrfikësve dhe të urgjencës) dhe shenjat dalluese që ndalojnë pirjen e duhanit, pijeve alkoolike, drogës dhe përdorimin e telefonit celular.				
4.2. Shkolla ofron mbështetje emocionale, sociale dhe akademike për të gjithë nxënësit.	4.2.1. Shkolla ka hartuar historikun e saj, i cili është i ekspozuar në mjediset e shkollës.				
	4.2.2. Shkolla ekspozon në mjediset e saj veprimtari dhe produkte shkencore, artistike, sociale, sportive etj.				
	4.2.3. Shkolla siguron respektimin e ndërsjellë mes dallimeve individuale (gjinia, raca, gjuha, kultura, shtetësia, krahina, përkatësia fetare etj.).				
	4.2.4. Mësuesit ¹¹ përdorin strategji të mësimdhënies dhe të nxënies, të cilat nxisin zhvillimin emocional dhe social të nxënësve, të tilla si: dëgjimin efektiv, zgjidhjen e konflikteve, vetëreflektimin, rregullimin emocional, empatinë, përgjegjësinë personale dhe vendimmarrjet etike.				
	4.2.5. Shkolla realizon veprimtari plotësuese, të tilla si: veprimtari kulturore-artistike, sportive, letrare, shkencore, mjedisore, ekskursione, vizita dhe konkurse, bazuar në interesat dhe nevojat reale të nxënësve.				
	4.2.6. Ekskursionet realizohen në përputhje me kriteret e përcaktuara në udhëzimet zyrtare.				
	4.2.7. Shkolla përdor të ardhurat e kontributeve të bordit të shkollës në funksion të arritjeve të nxënësve.				

¹¹ Ky përshkrues praktik realizohet me vëzhgime në orë mësimore edhe me pyetësorë/intervista etj.

4.3. Shkolla mbështet nxënësit me nevoja të veçanta ¹² .	4.3.1. Shkolla identifikon nxënësit me prirje të veçanta dhe me vështirësi në të nxënë.				
	4.3.2. Shkolla realizon plane të avancuara për nxënësit me prirje të veçanta dhe me vështirësi në të nxënë, të cilat hartohen nga ekipet lëndore.				
	4.3.3. Shkolla mbështet nxënësit të marrin pjesë në veprimtari të ndryshme lokale, kombëtare, ndërkombëtare.				
	4.3.4. Shkolla inkurajon nxënësit të mbështesin dhe të lehtësojnë moshatarët e tyre në procesin e të nxënit.				
	4.3.5. Shkolla motivon nxënësit duke promovuar sukseset dhe arritjet e tyre (certifikata, shpërblime etj.).				
	4.3.6. Shkolla ka ngritur komisionin për nxënësit me aftësi të kufizuara, i cili funksionon në përputhje me udhëzimet zyrtare.				
	4.3.7. Shkolla ka bashkëpunuar me komisionin multidisiplinor të ngritur pranë ZVAP-së, për vlerësimin e nxënësve me AK.				
	4.3.8. Mësuesi ndihmës bashkëpunon me mësuesin lëndor, punonjësin e shërbimit psiko-social dhe prindin, për hartimin e planit edukativ individual, i cili miratohet nga komisioni i shkollës për nxënësit me aftësi të kufizuara.				
	4.3.9. Mësuesi ndihmës zbaton planin edukativ individual, për zhvillimin e potencialit intelektual, social-emocional, zhvillimor e fizik të nxënësit, duke nxitur kalimin e nxënësit nga varësia në pavarësi.				
	4.3.10. Mësuesi lëndor dhe mësuesi ndihmës bashkëpunojnë me prindërit, në mënyrë që njohuritë e marra dhe veprimtaritë e zhvilluara në shkollë, me ato në shtëpi, të plotësojnë dhe të përforcojnë njëra-tjetrën.				
	4.3.11. Mësuesi ndihmës raporton te komisioni i shkollës mbi ecurinë e fëmijës dhe realizimin e planit edukativ individual.				
4.4. Shkolla u garanton nxënësve të drejtat dhe ushtrimin e detyrave të tyre.	4.4.1. Shkolla u mundëson nxënësve për të ushtruar të drejtat dhe detyrat e tyre, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore.				
	4.4.2. Nxënësit ndihen të sigurt nga dhuna fizike, dhuna verbale dhe përjashtimi.				
	4.4.4. Shkolla zgjidh konfliktet në mënyrë konstruktive, duke përdorur metoda të disiplinimit pozitiv.				
	4.4.5. Shkolla merr në konsideratë mendimin e nxënësve, prindërve dhe aktorëve të tjerë për përmirësimin e klimës në shkollë.				
	4.4.6. Komisioni i etikës dhe sjelljes funksionon për përmirësimin e klimës në shkollë, për të garantuar mirëqenien fizike, sociale dhe emocionale të të gjithë nxënësve.				
4.5. Psikologu/punonjësi social kontribuon për mirëqenien e të gjithë individëve dhe grupeve në shkollë.	4.4.7. Qeveria e nxënësve organizon veprimtari të ndryshme në shkollë dhe jashtë saj, për krijimin e një klime pozitive.				
	4.5.1. Psikologu/punonjësi social në bashkëpunim me mësuesit dhe prindërit identifikon nxënësit me probleme në sjellje dhe me vështirësi në të nxënë.				
	4.5.2. Psikologu/punonjësi social i shkollës analizon të dhëna mbi: – ndryshime të sjelljes së nxënësve; – nivelin social dhe ekonomik të nxënësve; – marrëdhëniet me shokët; – marrëdhëniet me mësuesit; – komunikimin dhe marrëdhëniet me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve; – dukurinë e bullizmit; – mënyrën se si e kalojnë nxënësit kohën e lirë; – varësinë e nxënësve ndaj internetit; – varësinë ndaj pirjes së duhanit, alkoolit dhe drogave.				
	4.5.3. Psikologu/punonjësi social realizon plane individuale parandaluese dhe rehabilituese për nxënësit me probleme në sjellje dhe me vështirësi në të nxënë.				
	4.5.4. Psikologu/punonjësi social bashkëpunon me punonjësit arsimorë, nxënësit dhe prindërit, për parandalimin dhe				

¹² Nxënësit me nevoja të veçanta janë: nxënësit me prirje të veçanta, nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit me aftësi të kufizuara.

	eliminimin e çdo forme dhune nga punonjësit arsimorë ndaj nxënësve dhe nxënësve ndaj njëri-tjetrit.				
	4.5.5. Psikologu/punonjësi social zhvillon takime sensibilizuese me nxënësit mbi parandalimin dhe eliminimin e abuzimeve me alkoolin, duhanin, drogat, format e dhunës, si dhe fenomenet sociale që ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre psikologjik, social dhe akademik.				
	4.5.6. Psikologu/punonjësi social zhvillon takime sensibilizuese me prindërit mbi format e prindërimit, tematika që lidhen me zhvillimin moshor, komunikimin prind-fëmijë dhe disiplinimin pozitiv.				
	4.5.7. Psikologu/punonjësi social informon mësuesit dhe drejtuesit e shkollës mbi zhvillimet moshore tipike të nxënësve dhe problemet gjatë të mësuarit dhe të të nxënësit.				
	4.5.8. Psikologu administron dhe interpreton teste psikologjike.				
	4.5.9. Psikologu/punonjësi social raporton me shkrim te drejtuesit i shërbimit psiko-social në ZVAP, për çdo formë dhune të punonjësve arsimorë dhe prindërve me nxënësit.				
4.6. Oficeri i sigurisë ¹³ kontribuon në krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë dhe përreth saj.	4.6.4. Oficeri i sigurisë harton planin e sigurisë së shkollës, duke përcaktuar risqet e mundshme, daljet emergjente, për të minimizuar burimet e aksidenteve.				
	4.6.5. Oficeri i sigurisë evidenton situatat e parregullta të rendit dhe të sigurisë publike, brenda dhe jashtë perimetrit të shkollës, duke njoftuar oficerin e policimit në komunitet.				
	4.6.6. Oficeri i sigurisë realizon takime informuese me nxënësit, stafin pedagogjik dhe prindërit, për rastet që paraqesin rrezikshmëri shoqërore, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit qytetar.				
	4.6.7. Oficeri i sigurisë bashkëpunon me shkollën, për përmirësimin e nivelit të ndërgjegjësimit për problematika, si: përdorimi i drogës, bullizmi, siguria në internet, pasojat e dhunës dhe krimit.				
	4.6.8. Oficeri i sigurisë njeh nxënësit me rregullat, ligjin dhe drejtësinë.				
	4.6.9. Oficeri i sigurisë menaxhon rastet emergjente dhe të dhunës në shkollë dhe përreth saj.				
	4.6.10. Oficeri i sigurisë u ofron prindërve asistencë për zgjidhjen e situatave të ndryshme për menaxhimin e konflikteve.				
	4.6.11. Oficeri i sigurisë bashkëpunon me psikologun/ punonjësin social për të ndërmjetësuar palët në situata konfliktuale brenda mjediseve të shkollës.				
	4.6.12. Oficeri i sigurisë bashkëpunon me agjencitë ligjzbatuese dhe shërben si ndërlidhës mes Policisë së Shtetit dhe komunitetit me qëllim parandalimin e veprave kriminale.				
	4.6.13. Oficeri i sigurisë raporton periodikisht mbi situatat/incidentet pranë autoriteteve përgjegjëse.				
4.7. Shkolla ndërvepron me prindërit dhe komunitetin për përmirësimin e mirëqenies në shkollë.	4.7.4. Prindërit dhe komuniteti ndihen të mirëpritur në shkollë.				
	4.7.5. Shkolla informon prindërit mbi të drejtat dhe detyrat e tyre.				
	4.7.6. Shkolla planifikon veprimtari për përfshirjen e komunitetit në jetën e shkollës.				
	4.7.7. Shkolla ofron mjediset dhe materialet e saj për nevojat e komunitetit.				
	4.7.8. Shkolla në bashkëpunim me nxënësit, prindërit dhe komunitetin, organizon veprimtari për të njohur kulturën e komunitetit, vlerat dhe traditat e tij.				
	4.7.9. Shkolla mban kontakte të vazhdueshme me prindërit, duke përdorur metoda të frytshme informimi.				
	4.7.10. Këshilli i prindërve të klasës dhe shkollës japin ndihmesën e tyre në mbarëvajtjen e shkollës, në përputhje me udhëzimet zyrtare.				
	4.7.11. Shkolla informon familjet dhe komunitetin për çështjet që duhen përmirësuar.				

¹³ Ky tregues vlerësohet në shkollat që ofrohet shërbimi i oficerit të sigurisë.

BAZA LIGJORE

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
5. Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”
6. Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
7. Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, 2014-2020.
8. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016-2020, si dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë 2016-2020.
9. Kodi i etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar publik dhe privat, miratuar nga ministri i Arsimit dhe Sportit, më 30.11.2013.
10. VKM-ja nr. 707, datë 28.08.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 107, datë 10.02.2010 të Këshillit të Ministrave ‘Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar’”, i ndryshuar.
11. VKM-ja 319, datë 12.04.2017, “Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave”.
12. VKM-ja nr. 600, datë 9.10.2018, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kritereve për oficerët e sigurisë”.
13. Urdhër nr. 477, datë 30.09.2019, “Për miratimin e standardeve profesionale për formimin e drejtuesve të institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar”.
14. Urdhër nr. 195, datë 25.04.2016, “Për miratimin e dokumentit ‘Edukimi dhe formimi i mësuesve për gjithëpërfshirjen-Profil i mësuesit gjithëpërfshirës’”.
15. Urdhër nr. 336, datë 14.07.2011, “Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”.
16. Udhëzim nr. 15, datë 12.07.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”.
17. Udhëzimi nr. 23, datë 02.08.2013, “Për ndjekjen e gjimnazit me kohë të pjesshme”, i ndryshuar.
18. Udhëzimi nr. 25, datë 02.08.2013, “Për organizimin e funksionimin e qeverisë së nxënësve”, i ndryshuar.
19. Udhëzimi nr. 28, datë 02.08.2013, “Për pajisjen e nxënësve me dëftesë klase”.

20. Udhëzimi nr. 30, datë 02.08.2013, “Për rregulloren tip të institucioneve arsimore”.
21. Udhëzimi nr. 26, datë 02.08.2013, “Për përcaktimin e detyrave dhe funksioneve të këshillit të mësuesve”.
22. Udhëzimi nr. 36, datë 13.08.2013, “Për procedurat për arsimin e fëmijëve të ngujuar”.
23. Udhëzimi nr. 38, datë 13.08.2013, “Për arsimimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e përkujdesjes shoqërore”.
24. Udhëzimi nr. 43, datë 21.08.2013, “Për planifikimin e fondeve buxhetore, prokurimin dhe blerjen e mjeteve mësimore për institucionet arsimore publike”.
25. Udhëzimi nr. 58, datë 12.11.2013, “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit arsimor publik”.
26. Udhëzimi nr. 44, datë 21.08.2013, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendi”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 14, datë 10.05.2017.
27. Udhëzimi nr. 21, datë 08.08.2014, “Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë”.
28. Udhëzimi nr. 42, datë 15.10.2014, “Për arsimimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e paraburgimit, të vuajtjes së dënimit”.
29. Udhëzimi nr. 14, datë 12.05.2015, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pranimin në shkollat e arsimit të orientuar”.
30. Udhëzimi nr. 2, datë 12.02.2015, “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”, i ndryshuar.
31. Udhëzimi nr. 21, datë 09.07.2015, “Për procedurat e transferimit të nxënësve nga një nivel/drejtimit i arsimit profesional në gjimnaz”.
32. Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015, “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca në arsimin bazë”.
33. Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015 “Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe nxënësve, si dhe përmbajtjen e dosjeve të tyre personale”.
34. Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave nr. 35, datë 14.09.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr. 51, datë 20.09.2013 të ministrit të Arsimit dhe ministrit të Financave, ‘Për procedurat e përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit për botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar’”.
35. Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016, “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”.
36. Udhëzim nr. 4, datë 11.04.2016, “Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor”.
37. Urdhri nr. 8, datë 12.01.2017, “Për miratimin e kornizës kurrikulare të arsimit parashkollor dhe standardeve të zhvillimit dhe të të nxënësve të fëmijëve 3-6 vjeç”.
38. Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017, “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.
39. Udhëzim nr. 25, datë 25.07.2018, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”.
40. Udhëzimi nr. 17, datë 09.05.2018, “Për procedurat e ndjekjes së arsimit të detyruar nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë dhe për arsimin me kohë të pjesshme në arsimin bazë”.

41. Udhëzimi nr. 34, datë 16.11.2018, “Për ndalimin e telefonit celular në institucionet arsimore parauniversitare”.
42. Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.
43. Udhëzimi nr. 13, datë 22.05.2019, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”.
44. Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.
45. Udhëzimi katërminstoror midis Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr. 10, datë 25.02.2015, “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik, për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”.
46. Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe lëndor të mësuesit në AMU e AML, IZHA, 2016.
47. Urdhër nr. 477, datë 30.09.2019, “Për miratimin e Standardeve profesionale për formimin e drejtuesve të institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar”.
48. Udhëzimi nr. 2, datë 28.01.2020, “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”.
49. Urdhër nr. 811, datë 14.12.2018, “Për miratimin e udhëzuesit për zbatimin e nismës ‘Bëjmë detyrat e shtëpisë’”.
50. Urdhër nr. 440, datë 25.7.2018, “Për hapjen e klasave të profilizuara në sport në institucionet e arsimit bazë të sistemit arsimor parauniversitar”.
51. Urdhër nr. 477, datë 06. 12. 2014, “Për miratimin e Kartës së Performancës së Shkollës dhe udhëzuesit të saj”.
52. Urdhër i përbashkët nr. 3348/1, datë 18.04.2018, i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Drejtësisë “Për rregullimin e procesit arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur”.
53. Urdhër nr. 531, datë 14.09.2018, i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për ngritjen e zyrës së koordinimit dhe monitorimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme për oficerët e sigurisë në shkollat publike”.
54. Urdhër nr. 344, datë 19.08.2013, “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social”.
55. Urdhër nr. 6, datë 10.01.2018, “Për zbatimin e nismës tri lëndë në 6 orë”.
56. Urdhër nr. 493, datë 30.07.2018, “Për mospërdorimin e telefonit celular gjatë procesit mësimor në shkollë”.
57. Urdhër nr. 167, datë 11.04.2016, “Për miratimin e rregullores për procedurat e organizimit dhe zhvillimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor”.

58. Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 526 prot., datë 17.02.2018, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Drejtësisë “Për arsimimin e individëve në institucionet e paraburgimit të vuajtjes dënimit në Republikën e Shqipërisë”.
59. Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 7522 prot., datë 12.7.2018, “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës shkollore” ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Brendshme.
60. Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 4481 prot., datë 25.4.2018, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë.
61. Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 4661/1 prot., datë 18.6.2015, “Për implementimin e projektit ‘Mësimet të shahut në shkollë’”, ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Federatës Evropiane të Shahut dhe Federatës Shqiptare të Shahut.
62. Marrëveshja e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me Agjencinë Ekzekutive për Arsimin, Mediet Audiovizive dhe Kulturën e Komisionit Evropian.
63. Memorandumi i Bashkëpunimit nr. 363 prot., datë 25.1.2016 dhe nr. 600 prot., datë 25.1.2016, “Për edukimin mbi dhe përmes arteve dhe trashëgimisë”, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
64. Memorandumi i Mirëkuptimit me nr. 2436 prot., datë 28.2.2019, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Këshillit Britanik në Shqipëri për zbatimin e projektit “Shkollat e shekullit 21”.
65. Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2014.
66. “Standardet e Shkollës si Qendër Komunitare” dhe udhëzuesi për “Shkollat Qendër Komunitare”, tetor 2014.
67. Korniza e vlerësimit të nxënësve për arsimin parauniversitar (MAS, nr. 5563, datë 23.07.2015).
68. Nivelet e arritjeve të kompetencave, shkallët 3-4, IZHA, shtator 2016.
69. Nivelet e arritjes së kompetencave, shkalla V dhe VI, IZHA, tetor 2018.
70. Nivelet e arritjes së kompetencave të fushave të të nxënës, (arsimi fillor) klasa I-III dhe IV-V, IZHA, mars 2019.
71. Vlerësimi i nxënësve në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë, ASCAP, 2019.
72. Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës në gjimnaz, IZHA, tetor 2016.
73. Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës në Arsimin Fillor, IZHA, prill 2018.
74. Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës në Arsimin e Mesëm të Ulët, IZHA, janar 2017.
75. Udhëzues kurrikular lëndor në Arsimin e Mesëm të Lartë, IZHA, 2018.
76. Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës me zgjedhje në gjimnaz, IZHA, maj 2018.
77. Udhëzues kurrikular lëndor në Arsimin e Mesëm të Lartë, IZHA, 2018.
78. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, 2016-2020.
79. Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016-2020.

80. Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Veprimit të Qenieve Njerëzore.

81. Plani Strategjik i Veprimit kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit, 2017-2020.

PËRKUFIZIME

Aftësi të menduari të rendit më të lartë: Të menduarit që shkon përtej mbajtjes mend të fakteve bazë dhe të kuptuarit, se je i/e aftë për të analizuar, zbatuar dhe krijuar njohuri.

Bashkëveprim: Ky term i referohet pikëpamjes sociale konstruktiviste, ku individët realizohen nëpërmjet ndërveprimeve me njëritjetrin dhe me mjedisin ku jetojnë.

Burimet e të nxënit: “Burimet e të nxënit” janë burimet njerëzore (mësues, nxënës, prindër, ligjërues të ftuar etj.), objektet reale (në/nga mjedis natyror dhe social/kulturor), media mësimdhënëse (dëgjimore, pamore, dëgjimore-pamore dhe interaktive/TIK) dhe ndihmëse e mësimdhënies (dërrasat me shkumës, SMART Board-et etj.).

Diferencim: Praktika e modifikimit dhe përshtatjes së mësimi, të materialeve, përmbajtjes, projekteve, produkteve të nxënësve dhe të rezultateve, për t’iu përgjigjur nevojave të ndryshme të të nxënit, që kanë nivele të ndryshme aftësie, zotësie, stileshe të nxëni, sfondesh nga vijnë, moshash etj. Në një klasë të diferencuar, mësuesit pranojnë që të gjithë nxënësit janë të ndryshëm dhe kërkojnë metoda të ndryshme mësimdhënie për të qenë të suksesshëm në shkollë.

Drejtues: Drejtuesi tregon si arrihet qëllimi, nxit gjithëpërfshirjen e partneritetin, është shembull për t’u ndjekur, qëndron në pararojë dhe është më tepër një strateg se një teoricien.

“Feedback”-u: Ky term përmban informacion që nxënësi mund ta përdorë për t’u përmirësuar. Ai është komponent i rëndësishëm i procesit të vlerësimit formues. “Feedback”-u është pozitiv, i detajuar, realist, i drejtë, motivues, me shkrim ose me gojë.

Grupe interesi: Ky term përfshin tërësinë e individëve që kanë pikëpamje, ide, qëllime dhe interesa të përbashkët në fushën e arsimit dhe edukimit.

Karta e Performancës së Shkollës: Është një sistem i projektuar për informacion dhe dobishmëri me tregues sasiorë e cilësorë, që ofron të dhëna për arritjet e shkollës gjatë një viti shkollor, për një krahasim në nivel lokal/rajonar dhe kombëtar, i cili u shërben prindërve, drejtuesve, mësuesve, nxënësve, DRAP-it/ZVAP-së, komunitetit dhe gjithë të interesuarve, të analizojnë dhe të krahasojnë rezultatet e shkollës me tregues të ndryshëm të arritjeve në një dokument lehtësisht të përdorshëm.

Klima në shkollë: Ky term nënkupton marrëdhëniet sociale, gjendjen psikologjike, emocionale dhe mendore të individëve në shkollë.

Komunitet: Komuniteti përbëhet nga grupe njerëzish që jetojnë në një zonë të caktuar dhe që lidhen nga interesa e qëllime të përbashkëta për zhvillimin e arsimit dhe edukimit në zonën e tyre.

Komunitet mësimor: Një grup njerëzish që ndajnë vlera dhe besime të përbashkëta dhe që janë të përfshirë aktivisht në procesin e të mësuarit nga njëri-tjetri dhe mbështetin njëri-tjetrin në këtë proces.

Konfidencialiteti: Ky term nënkupton sigurimin e informacionit, i cili përcakton mbrojtjen e informacionit nga qasja, përdorimi, zbulimi, shkatërrimi, modifikimi, leximi, inspektimi apo regjistrimi i paautorizuar.

Listë kontrolli: Ky është instrument që përmban një listë me tema, objektiva, aftësi, njohuri për të cilat nxënësi do të vrojtohet.

Menaxher: Menaxheri planifikon, organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e shkollës, prandaj menaxhimi është aftësia për të transformuar inputet në rezultate, përmes procesit të planifikimit, organizimit të punës, kontrollit dhe vetëvlerësimit të rezultateve të arritura.

Metodë e individualizuar e mësimdhënies/e të nxënit: Një tip mësimdhënieje/të mësuarit sipas së cilës mësuesi merr në konsideratë kapacitetet, nevojat, përvojat individuale etj., të nxënësit, kur projekton/realizon/vlerëson procesin e mësimdhënies/të mësuarit.

Metodë gjithëpërfshirëse planifikimi: Metodë gjithëpërfshirëse planifikimi do të thotë planifikim që siguron veprimtari të të mësuarit për të gjithë grupin, grupin e vogël dhe individët, të bazuar në nevojat dhe interesat e fëmijëve në klasë.

Mjedis mësimor: Në këtë dokument, mjedisi mësimor u referohet mjedisëve fizike (çfarë materialesh dhe mobilie ka në mjedisin e fëmijëve, si janë të rregulluara ato, ku janë vendosur etj.) dhe shoqërore/emocionale, ku mësojnë fëmijët. Mjedis mund të jetë në shtëpi, në komunitet ose në shkollë/qendrat ditore të kujdesit/klasë.

Mjedis i të nxënit: Mjedis i të nxënit është ai fizik, emocional, shoqëror dhe akademik.

Model: Modeli i tregon nxënësit si të kryhet një detyrë ose të arrihet një sjellje e dëshiruar, duke pritur që nxënësit të mund të kopjojnë modelin. Nënkupton të menduarit ose të folurit me zë rreth mënyrës si të punohet gjatë kryerjes së një detyre. Synimi është imitimi i sjelljes së një eksperti nga ana e nxënësit.

Nxënësi me aftësi të kufizuar: Ky term përfshin kategorinë e nxënësve që kanë vështirësi fizike, mendore, emocionale ose vështirësi të tjera (me ose pa raport mjeko-ligjor).

Nxënësi me prirje të veçanta: Ky term përfshin kategorinë e nxënësve që shfaqin dukshëm prirje dhe rezultate të larta në fusha të ndryshme.

Objektivi: Objektivi i planit vjetor të shkollës përcakton masën në të cilën do të arrihet synimi.

Përshkrimi i notës përfundimtare vjetore: Ky përshkrim argumenton nivelin e arritjeve të kompetencave të lëndës, duke treguar pikat më të forta që ka nxënësi lidhur me përmbushjen e kompetencave të lëndës.

Prioriteti: Ky term nënkupton përparësinë që shkolla cakton, pasi ka analizuar gjendjen.

Pyetje e hapur: Një pyetje që ka shumë përgjigje të sakta të mundshme dhe që e lejon individin të përgjigjet në shumë mënyra.

Pyetje e mbyllur: Një pyetje që ka vetëm një përgjigje të drejtë dhe/ose që njihet tashmë nga ai që pyet, ose që kërkon një përgjigje minimale nga ana e personave që përgjigjen.

Reflektim: Veprimi i të menduarit mbi një përvojë apo ngjarje të kaluar dhe të ndikimit që ka patur. Reflektimi është një proces me anë të të cilit personi rishqyrton të kaluarën e tij/të saj, si mënyrë për të përmirësuar të ardhmen.

Rubrika e vlerësimit: Përfshin kriteret e një sistemi vlerësimi, duke përshkruar qartë karakteristikat e performancës.

Simbole të vlerësimit: Janë shenja, si: +, -, ↗ ↘, O, ●, V, G, <, >, ✓ etj., që përdoren në legjendën e evidencave personale të mësuesit.

Skema e vlerësimit: Është një udhëzues që tregon se si do të pikëzohen përgjigjet e nxënësve.

Stil të mësuarit: Metoda/mënyra të ndryshme të të mësuarit që e bëjnë atë më efektiv e kuptimplotë për nxënësin, që përfshijnë metodën dëgjimore, pamore, kinestetike, konkrete e artistike; çfarë ritmi të mësuarit parapëlqen, të punojë i vetëm apo me të tjerë etj.

Strategji të mësimdhënies: Metodatat, procedurat dhe teknikat e mësimdhënies të përdorura për arritjen e synimit ose objektivit të procesit të të mësuarit. Strategjitë e mësimdhënies duhet të përputhen me stilin dhe aftësinë e të mësuarit të nxënësit dhe duhet të marrin parasysh përmbajtjen e procesit të të mësuarit.

Synimi i planit vjetor të shkollës: Ky term nënkupton prioritetin/prioritetet kryesor/e, ku shkolla do të përqendrojë përpjekjet e saj, për përmirësimin e arritjeve të nxënësve, në përputhje me strategjinë e arsimit parauniversitar përkatës.

Shërbim psiko-social: Është shërbimi që nënkupton identifikimin dhe kujdesin ndaj individëve që hasin vështirësi në ndërtimin e marrëdhënieve të llojit social, si dhe probleme mendore dhe psikologjike.

Shprehje vlerësuese: Janë komentet e argumentuara që bën mësuesi për arritjet e nxënësit.

Tabela e vlerësimit: Tabela e vlerësimit është pjesë e testit që tregon në mënyrë të përshkallëzuar pikët dhe notën.

Testimi kombëtar: Është testimi që mat arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, në fund të një niveli shkollor.

Të menduarit krijues: Prodhimi i ideve dhe mendimeve të reja. Të menduarit imagjinar synon prodhimin e rezultateve që flasin për sintezë idesh ose për proces të ndryshëm të menduari, jo tradicional.

Të mësuarit bashkëpunues: Një metodë e të mësuarit ku nxënësit punojnë bashkë në grupe, zakonisht me synimin e plotësimit të një detyre specifike nëpërmjet bashkëpunimit. Kjo metodë ndihmon nxënësit që të krijojnë veti lidërshipi dhe aftësi të punojnë me të tjerët, si një skuadër. Të mësuarit është bashkëpunues dhe jo një veprimtari e pastër “solo”, ne mësojmë me të tjerët dhe nga të tjerët.

Të mësuarit e vetënormuar: Të mësuarit është i vetënormuar, kur nxënësit e menaxhojnë mirë kohën dhe monitorojnë rezultatet e tyre pavarësisht nga pengesat.

Të mësuarit konstruktiv: Të mësuarit është konstruktiv, kur mendimi nuk ekziston në botën e jashtme, por ai formohet nga nxënësit, ndërsa ata bashkëveprojnë me botën e jashtme.

Të mësuarit kontekstual: Të mësuarit është kontekstual dhe ndodh kur nxënësit bashkëveprojnë në mënyrë të veçantë, duke marrë pjesë në veprimtari shoqërore dhe kulturore.

Të nxënës: Procesi i fitimit të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve ose vlerave nëpërmjet ndërveprimeve, studimit, përvojës ose mësimdhënies, që shkakton një ndryshim të sjelljes, që është këmbëngulës, i matshëm dhe i specifikuar, ose që lejon një individ të formulojë një ndërtim të ri mendor (njohuri konceptuale, të tilla si qëndrime ose vlera). Është një proces që varet nga përvoja dhe çon drejt ndryshimeve afatgjata të sjelljes potenciale.

Të nxënës aktiv: Një proces me anë të të cilit nxënësit përfshihen aktivisht në procesin e të mësuarit, dhe jo të përthithin “pasivisht” shpjegimin e mësuesve. Të mësuarit aktiv përfshin veprimtari konkrete dhe i angazhon nxënësit, që të përputhin çfarë u duhet të mësojnë, me interesat, nivelet e të kuptuarit dhe të zhvillimit të tyre. Pjesëmarrje aktive përfshin të qenit pjesë e proceseve demokratike, të paturit e lirisë për të zgjedhur, për të marrë pjesë në vendime etj. Të nxënës aktiv, po ashtu, nënkupton të lexuarit, të shkruarit, diskutimin dhe përfshirjen në zgjidhjen e problemeve, në analiza, sinteza dhe vlerësime.

Veprimtari plotësuese: Veprimtari kulturore-artistike, sportive, letrare, shkencore, mjedisore, si dhe ekskursione, vizita, konkurse, festime të ditëve të shënuara, sipas interesave dhe nevojave reale të nxënësve, në funksion të përmbushjes së kërkesave të kurrikulës.

Vetëvlerësim: Shqyrtimi i plotësuar nga vetë nxënësi për të vlerësuar punën që bën, sjelljet, pikat e forta dhe të dobëta, me qëllim monitorimin dhe ndryshimin e rezultateve të veta.

Vizioni i shkollës: Vizioni i shkollës (në planin afatmesëm) paraqitet në formën e arritjeve, idealeve, aspiratave, shpresave, dëshirave që mendohet se mund të arrihet nga shkolla dhe nxënësit e saj pas 4 vitesh.

Vlerësimi i kurrikulës: Procesi i përcaktimit të vlerës së një aspekti ose të tërë kurrikulës. Në varësi të përkufizimit të kurrikulës, objekt i vlerësimit mund të jenë nevojat për kurrikulën, politika e kurrikulës, përmbajtja e kurrikulës, procesi i mësimdhënies, mjetet mësimore, rezultatet e të nxënit, përvetësimi i kurrikulës nga nxënësit, efektshmëria e mësimdhënies dhe mjedisi i të nxënit.

Vlerësimi i mësuesit: Është procesi i përshkrimit dhe i gjyqimit të meritave dhe të vlerave të mësuesit mbi bazën e njohurive, të aftësive, të sjelljeve dhe të rezultateve të mësimdhënies së tij, të cilat krahasohen me standarde të caktuara.

Vlerësimi i procesit: Ky vlerësim ka tri qëllime kryesore: 1) të zbulojë ose të parashikojë defektet në procedurat ose gjatë zbatimit të programit, projektit; 2) të sigurojë informacion për vendimet e programuara; 3) të regjistrojë procedurat siç kanë ndodhur. Vlerësimi i procesit siguron një informacion për kapërcimin e vështirësive, për marrjen e vendimeve të mëtejshme dhe për interpretimin e rezultateve të programit, projektit.

Vlerësim: Vlerësimi në arsim është procesi gjatë të cilit gjykohet mbi bazën e një kriteri për vlerën e një rezultati arsimor, mbi bazën e informacioneve të grumbulluara nga procesi i të nxënit.

Vlerësimi i të nxënit (vlerësimi përmbledhës): Është vlerësimi që përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna, që tregojnë nëse mësimdhënia ka realizuar qëllimin e saj.

Vlerësim i vazhduar (formues): Është vlerësimi që mbledh të dhëna dhe dëshmi rreth të nxënit të nxënësve gjatë procesit të të nxënit.

Vlerësimi periodik: Është vlerësimi që mat nivelin e arritjeve të nxënësit në fund të çdo periudhe të vitit shkollor dhe përmban tri nota: vlerësimin e vazhdueshëm, vlerësimin me test dhe vlerësimin e portofolit.

Vlerësimi përfundimtar: Është vlerësimi që mat nivelin e arritjeve të kompetencave të lëndës në përfundim të vitit shkollor.

Vlerësimi vjetor progresiv/regresiv: Është vlerësimi që bëhet në rastet, kur ecuria e nxënësit është e dukshme progresive ose regressive gjatë dy periudhave të fundit.

BIBLIOGRAFIA

Australian student wellbeing framework, marrë nga https://www.studentwellbeinghub.edu.au/docs/default-source/aswf_booklet-pdf.pdf.

CDRSEE/IPA, Mësimdhënia dhe të të mësuarit, 2013.

Education Review Office: *Wellbeing Indicator Framework*, marrë nga <https://www.ero.govt.nz/publications/wellbeing-for-success-draft-evaluation-indicators-for-student-wellbeing/section-two-wellbeing-indicator-framework/>.

European Commission/EACEA/Eurydice, *Assuring Quality in Education: Policies and Approaches to School Evaluation in Europe. Eurydice Report*, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2015.

FNBE, Learning and competence 2020, 2019.

IKAP, Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i shkollës, 2011.

International Step by Step Association, “*Competent educators of the 21st century- ISSA’s principles of quality pedagogy*”, 2010, marrë nga <https://www.issa.nl/sites/default/files/pdf/Publications/quality/Quality-Principles-final-WEB.pdf>.

Instituti pedagogjik i Kosovës, Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë, 2016, marrë nga <http://ipkmasht.rks-gov.net/kriteret-dhe-treguesit-e-cilesise-se-performances-se-shkolles/>.

The Inspectorate wishes to thank Kilternan N.S., Kilcolgan, Co. Galëay for permission to use the cover photographs *Looking at our school*, A quality framework for primary school, 2016.

Karameta P., Arsimi i gjeneratës tjetër: Konstruktivizmi, Kurrikula, Kompetenca, 2014.

Karameta P., Inspektimi i shkollave: Sistemi, procesi, metodologjia, 2003.

Konnu A. and Rimpelw M., “Well-being in schools: a conceptual model” Vol. 17, No. 1 © Oxford University Press. University of Tampere, Helsinki, Finland, 2002.

Misha A., Vlerësimi i shkollës: tregues, standarde, instrumenta, 2003.

National School Climate Standards, marrë nga www.schoolclimate.org/themes/schoolclimate/assets/pdf/policy.

Pasku V., Inspektimi i plotë i shkollës, 2004.

Pasku V., Peshkatari M., Muça Sh., Manual-inspektimi i plotë i shkollës, 2004.

Pasku V., Vlerësimi, monitorimi dhe supervizioni në arsim, 2012.

Peçi B., Konstruktivizmi dhe teoritë arsimore, 2004.

Performance indicators for Hong Kong Schools, Quality Assurance&School-based Support Division Education Bureau, 2016, marrë nga https://www.edb.gov.hk/attachment/en/sch-admin/sch-quality-assurance/performance-indicators/PI-2016_Eng.pdf.

Quality Assurance&School-based Support Division Education Bureau, *Performance indicators for Hong Kong Schools*. 2016, marrë nga https://www.edb.gov.hk/attachment/en/sch-admin/sch-quality-assurance/performance-indicators/PI-2016_Eng.pdf.

SICI, “Six models of lesson observation: an international perspective”, No. 180022, May 2018, marrë nga <http://www.sici-inspectorates.eu/getattachment/7e62a765-f133-48c8-bb16-e7f76b2829f3>.

Tankersley D., Brajkovic S., Handzar S., Rimkiene R., Sabaliauskiene R., Trikić Z., Vonta T., Ph.D, ISSA's principles of quality pedagogy, 2010.

UNESCO, Albania Education Policy Review: Issues and Recommendations, 2017.

Virginia Department of Education, Guidelines for Uniform Performance Standards and Evaluation Criteria for Principals, 2012, marrë nga http://www.doe.virginia.gov/teaching/performance_evaluation/guidelines_ups_eval_criteria_principals.pdf.